



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 2 SHKURT 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE  
2 FEBRUARA 2012. GODINE**

**SHKURT – FEBRUAR  
2012**

E enjte, 2 shkurt 2012

Drejtון seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e Mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kemi numër të mjaftueshëm të deputetëve të pranishëm për të filluar me punë. Kalojmë menjëherë në pikën e parë të rendit të ditës:

## 1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës.

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës, është e kufizuar në 30 minuta. Në emër të grupit parlamentar 5 minuta, në emër të deputetit 3 minuta. Replikë, e dini edhe ju, nuk ka.

Do të fillojmë me deputetin Hashim Deshishku. Le të deklarohet në emër të kujt e merr fjalën, në emër të vetin, apo të grupit?

HASHIM DESHISHKU: Flas në emër të Grupit, kryetar.

I nderuari kryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete,

Duke marrë parasysh ecuritë e deritashme në zhvillimin e energjetikës, kam përshtypjen se për shkak të mos punës dhe mos veprimit të Qeverisë së Kosovës, jemi duke hyrë gjithnjë e më thellë në krizë.

Nuk po e them këtë për shkak të reduktimeve të mëdha, të cilat, për fat të keq, janë shndërruar në përditshmëri dhe realitet, por më shumë nga konfuzioni që po krijohet rreth ardhmërisë së këtij sektori jetik për zhvillimin e vendit.

Në përbërje të mëhershme, por edhe në këtë të tanishmen, ky Kuvend ka miratuar një sërë dokumentesh që ndërlidhen me ardhmërinë e energjetikës. Njësoj ka vepruar Qeveria e Kosovës, si dhe ministrinë kompetente, por situata nuk ka ndryshuar aspak për të mirë.

Kosova ka kapacitete të njëjta gjeneruese. Kërkesa është në rritje, kurse mundësitë për import janë të kufizuara.

Shqetësimit tim, e mendoj edhe të qytetarëve, i ndihmojnë edhe shumë deklarata të njerëzve përgjegjës dhe kompetentë për energjetikë. Ata po sjellin në dyshim të gjitha përpjekjet e bëra, por edhe tërë konceptin që së paku e kemi në letra. Plasohen dyshime të paqëndrueshme për ndërtimin e termocentralit, por edhe për arsye të eksploatimit të linjtit. Unë mundohem të kuptoj zërat që vijnë nga shoqëria civile, e cila ngulë këmbë në shfrytëzimin e burimeve të ri përsëritshme.

Por si të arsyetohen ato, që sot nënçmojnë dhe nënvlerësojnë vendimet e veta që i kanë sjellë? Padyshim se të gjithë do të dëshironin të furnizohen nga energjia e pastër, por e kemi të qartë se kjo në Kosovë gati se është e pamundur.

Nga ana tjetër, krijimit të kësaj klime i ka kontribuar neglizhenca, përkatësisht dinamika tepër e ngadalshme drejt implementimit të projekteve që përmenden me vite:

Nën a) Ideja për ndërtimin e termocentraleve të reja nisë me kërkesën megalomane, me 2100 megavat, ndërsa më vonë ajo u reduktua në konceptin e quajtur “Kosova e re” që do të realizohet hap pas hapi, me termocentralet 500 deri 600 megavat. Por, konkretisht asgjë nuk po ndodhë drejt implementimit të projektit.

Nën b) Është bërë mjaft shumë zhurmë për Hidrocentralin e Zhurit, për shumë miliona që duhen të investohen dhe për 300 megavat që do të prodhohen. E vërteta është që për këtë projekt, ende nuk është punuar fizibiliteti, ndërkaq sipas deklaratave të njerëzve të këtij problemi, ai ka kosto të lartë dhe pak ditë punë gjatë vitit. Do të thotë është një luks që buxheti nuk mund ta përballojë, bashkë me dy autostrada, njëra në ndërtim e tjetra në ide.

Nën c) Nëse ndodhen mbi 600 hidrocentrale, të cilat shumë janë të përdorura si ilustrim në strategjinë e energjisë 2009 – 2018. Nga ana tjetër, vendi po futet në krizë gjithnjë më të madhe energjetike, e ajo do të jetë edhe më e rëndë gjatë viteve të tjera, meqenëse aktualisht Kosova mund të prodhojë pak më shumë se 800 megavat, ndërsa aktualisht kërkesa është edhe për 300 megavat më shumë. Ky ndryshim do të rritet edhe më shumë dhe pikërisht do të jetë pengesë për zhvillimin ekonomik, zbutjen e papunësisë dhe varfërisë, për të cilën po premtonte Qeveria e Kosovës.

Kur e them këtë, e kam parasysh edhe faktin e Termocentralit “Kosova A” për shkak të karbon-dioksidit, e po ashtu edhe për shkak të vjetërsisë dhe mungesës së rentabilitetit, dhe ajo duhet të mbyllet deri në vitin 2017. Pra, atëherë do të jemi në minus edhe për 250 – 300 megavat.

Krahasuar me gjendjen e tashme, nga ana tjetër, KEK-u nuk ka fuqi të ndihmojë shumë për përmirësimin e kësaj gjendje, as sot, e as në të ardhmen. Ai nuk ka para për import të energjisë elektrike, e as përkrahje nga buxheti i Kosovës, si e ka pasur në të kaluarën.

Prandaj, ky shqetësim është real, pasi që Qeveria e Kosovës, duke e nënkuptuar edhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, nuk po bën diçka konkret që vendi të mos futet në krizë edhe më të rëndë. Ato më shumë janë të fokusuar në shitjen e segmenteve të KEK-ut, ndërsa privatizimi i tyre ende nuk sjell shpresë se do të kemi energji elektrike të mjaftueshme si në cilësi, ashtu edhe në sasi.

Me qëllim të sigurimit të informacionit të plotë si dhe për tejkalimin e dilemave që ende janë në opinion Qeveria e Kosovës apo Ministria e Zhvillimit Ekonomik duhet të sjellin një raport rreth perspektivës së energjetikës. Ai duhet të jep përgjigje për problemet e shtruara:

Nën a) Deri në cilën fazë ka arritur projekti “Kosova e re” dhe kur pritet t’i japë kilovatët e parë?

Nën b) Cila është qasja ndaj Hidrocentralit të Zhurit. A ka studim të fizibilitetit dhe si mund të financohet ndërtimi i tij?

Nën c) Pse ende nuk ka tender për dhënien në koncesion ndërtimi të hidrocentraleve?

Dhe nën d) Cilat janë mundësitë për prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme dhe a janë bërë matjet për shfrytëzim të erës dhe diellit për këtë qëllim? Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Fadil Demaku, e ka fjalën. Vetëm trego, a në emër Grupit apo tëndin?

FADIL DEMAKU: Në emër timin. I nderuar kryetar i Kuvendit,  
Të nderuar zëvendëskryeministra,  
Ministra,  
Të nderuar kolegë deputetë,  
Ligji për statusin dhe të drejtat e kategorive të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që u miratua nga Kuvendi më 8.12.2011, ashtu siç është bërë, rregullon çështjen e dëshmorëve dhe invalidëve të UÇK-ës por nuk e ka trajtuar çështjen e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Dhe, siç e dimë të gjithë, neni 12 pika 2 të atij ligji thotë: “Të drejta në beneficione për veteranët e UÇK-ës si dhe kriteret e kualifikimit për njohjen dhe realizmin e tyre, do të rregullohen me ligj të veçantë”.

Gjithashtu, neni 15, pika 1, thotë se “Statusi i veteranit të UÇK-ës konstatohet nga një komision qeveritar”.

Miratimi i Propozim-vendimit nga Qeveria, javën e kaluar, për themelimin e komisionit qeveritar për verifikimin e statusit të veteranit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është për tu vlerësuar. Aty thuhet se “organizimi dhe fushëveprimi i punës, detyrat dhe përgjegjësitë e këtij komisioni, do të përcaktohen me një akt nën-ligjor”.

Ajo që është me rëndësi, mendoj unë, është se duhet t’i jepet prioritet maksimal dhe të përshpejtohen procedurat për nxjerrjen e atij akti nën-ligjor, në mënyrë që t’i mundësohet komisionit të fillojë punën për verifikimin e numrit të veteranëve të UÇK-ës.

Njohja dhe verifikimi i statusit të veteranit, është në radhë të parë në të mirë për vetë veteranët e UÇK-ës, sepse është fyerje për vlerat që i përfaqësojnë ata dhe për gjithë shoqërinë tonë nëse vërehen tendenca të ndryshme nga të pamerituarit, që në formë të paligjshme mundohen për ta shfrytëzuar një status të tillë.

Prandaj, komisioni qeveritar ta përfundojë punën e tij për verifikimin e të gjithë atyre që u takon statusi i veteranit të UÇK-ës, duke eliminuar dilemat dhe paqartësitë dhe në këtë

mënyrë të mundësohet fillimi i përgatitjes së projektligjit dhe sjelljen e tij sa më shpejt në lexim të parë në Parlament.

Unë besoj se deputetët kanë gatishmëri që të japin gjithë kontributin e tyre në plotësimin dhe amendamentimin e tij, kështu që sa më shpejt të bëhet një ligj i mirë dhe i favorshëm, i cili ruan dinjitetin e veteranit të UÇK-ës dhe ata të ndjehen të respektuar, komod dhe të trajtuar në formë meritore. Dhe, në këtë mënyrë, institucionet e vendit do të zgjidhnin përfundimisht një çështje që është më se e domosdoshme dhe që ka qenë e pa trajtuar prej se ekziston kjo kategori e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Deputetja Alma Lama, e ka fjalën.

**ALMA LAMA:** Faleminderit, zoti kryetar!

Unë desha të ndaj, së bashku me kolegët deputetë, shqetësimin në lidhje me një lajm që po qarkullon nëpër media, ku Kosova ka pranuar në bisedimet që po zhvillohen në Bruksel me Serbinë të prezantohet me një fusnotë.

Në fillim u tha nga përfaqësuesja e Delegacionit të Kosovës se një gjë e tillë është pranuar, ndërsa tani e ka thënë krejtësisht të kundërtën dhe është krijuar konfuzion jo vetëm në opinionin publik, por edhe tek ne, dhe thjeshtë duam ta dimë se si qëndron e vërteta: A ka pranuar me të vërtetë Kosova që të heqë dorë nga identiteti i saj shtetëror, apo jo?

E përsëris, nga lajmet, sepse vetëm lajmet kanë mbetur për të informuar, sepse nuk ka kurrfarë transparence në lidhje me këtë dialog. E kemi marrë vesh se Serbia kishte pranuar sipas këtyre lajmeve, në fakt sipas zonjës Tahiri, që të heqë nga Rezoluta 1244, pra pranimi me këtë. Dhe ky ishte kompromisi, sipas zonjës Tahiri, ndërkohë që po marrim vesh se Serbia absolutisht nuk ka heqë dorë nga kjo.

Heqja dorë nga termi Republikë, nga emri kushtetues, me të vërtetë shkon përtej imagjinatës dhe heqja dorë nga identiteti shtetëror - nga emri do të thotë edhe heqje dorë nga shtetësia.

Ju kujtoj se vetëm para dy ditësh, pikërisht ky Kuvend miratoi një Rezolutë ku kërkonte përmbylljen e procesit të mbikëqyrjes së pavarësisë dhe nuk e di, ndoshta Qeveria e ka keqkuptuar këtë, sikur se kjo është heqje dorë nga shtetësia. Kjo shkon besoj, edhe përtej propozimit të presidentit Ahtisari, i cili kërkon, në fakt propozimi i tij pas tre vjetësh të shqyrtohet nëse ka funksionuar mirë apo jo, për shembull ta zëmë me procesin e decentralizimit. Por, në asnjë moment nuk është kërkuar që në bisedime të tjera Kosova të heqë dorë nga emri i saj, me të cilin është shpallur shtet i pavarur.

Dua të ju kujtoj gjithashtu se kjo gjë po ndodhë, pra prezantimi i Republikës me fusnotë po ndodh pikërisht në momentin kur Parlamenti Evropian është angazhuar për të miratuar një rezolutë ku kërkohet në fakt që të përmirësohet terminologjia që përdoret për Kosovën. Pra, të hiqet fusnota 1244 dhe të shkohet një hap më përpara se sa ky që është

aktualisht. Dhe, në ndërkohë kemi proces krejtësisht të kundërt me atë që po bën Qeveria e Kosovës.

Nga ana tjetër, kemi dëgjuar ngjashmëri në krahasime, ose ngjashmëri me shtetin e Maqedonisë. Bota është e mbushur plot me konflikte, me shtete të cilat kanë kontestime të ndryshme. Mirëpo, mos të harrojmë se Kosova e ka shpallur pavarësinë si një rast sui generis.

Nuk di, por po kam përshtypjen që Qeveria e Kosovës pranon të krahasohet dhe të heqë dorë nga termi sui generis vetëm kur bëhet fjalë për krahasime negative.

Unë gjithashtu, dua t'i kërkoj Qeverisë së Kosovës që të kërkojë nga zonja Ashton që ajo të kërkojë nga pesë shtetet....

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Faleminderit! Deputetë, ju lutem, bëni dallimet në mes deklarimeve jashtë rendit të ditës dhe pyetjeve parlamentare. Nëse doni përgjigje, e kemi zëvendëskryeministrin këtu, dhe mund të përgjigjet.

*(Ndërhyrje)*

Por, ju lutem! Tjera herë, mos bëni pyetje. Kjo është për deklarime jashtë rendit të ditës dhe pas kësaj vjen rendi për pyetje parlamentare. Atëherë, respektoni këtë, sepse unë po them edhe njëherë, nëse edhe bëni pyetje unë Qeverisë kam me i dhënë leje menjëherë me u përgjigjur.

*(Ndërhyrje)*

Është shkelje procedurash, por edhe deputetët mos t'i shkelin procedurat. Vazhdojmë. Fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu. Atëherë, dalloni deklaratat jashtë rendit të ditës, me pyetjet parlamentare.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ndonëse në Draft-ligjin e ri për pensionet janë eliminuar disa anomali të mëhershme, prapëseprapë konsideroj se nuk është arritur akoma ajo që ne dëshirojmë, e mbi të gjitha vetë pensionistët.

Mendoj se përafërsisht ende jemi aty ku ishim, sepse as sot nuk kemi ligj për pensionet por në fakt kemi një ligj për mbikëqyrje sociale, të ndihmave apo edhe tjera, që parashihen me Kartën e të drejtave të njeriut.

Të punosh, përkatësisht të punosh në një detyrë, në çfarëdo vendi të punës qoftë, me çfarëdo shkollimi dhe madje edhe mbi 30, 35 apo 40 vjet përvojë punë, e të thonë – eja merri 35 euro, me të vërtetë kjo është një ironi.

Kështu po veprojmë ne me njerëzit me shkollim të lartë, universitar, por edhe me ata që kanë grada shkencore.

Merreni me mend, çfarë shteti super-social, jemi ne! Me të vërtetë, ky nuk është një gaf politik por është një papërgjegjësi e jona politike, pra e Qeverisë së shtetit, Qeverisë së Kosovës, ose më saktë thënë – e Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Po e marr vetëm një shembull, pa dash me iu mbet borxh kategorive tjera, siç janë mjekët dhe kategoritë tjera shumë të vlefshme të shoqërisë sonë. Çfarë merr sot një arsimtar pensionistë? Punëtorët e arsimit janë ndër luftëtarët e parë për çlirimin e Kosovës, që i thanë të parët “Jo sistemit arsimor diskriminues të Millosheviqit”. Ndërsa, ka shumë prej tyre që iu bashkuan krismave të lirisë, duke rënë me nderë në betejat e lavdishme të UÇK-ës.

Prandaj, propozoj që të gjithë pensionistët – punëtorë të arsimit, ta kenë edhe një privilegj bile edhe të luftëtarit të Kosovës. Në të kundërtën, unë pyes:

Si do të ndihen ata, pra një punëtor i arsimit, i cili tërë jetën i është përkushtuar këtij profesioni kaq fisnik dhe kaq të ndritur.

Si do t’i themi atij se sakrifica e juaj kushton vetëm 35 euro? E them 35 euro, sepse pensioni 45 euro i takon çdo pensionist sepse është pensionist i moshës, kurse pensioni i një pensionisti me 45 vjet përvojë pune është vetëm 35 euro, të deputetë.

Në anën tjetër, ne duhet të jemi seriozisht të brengosur pas petitionit të nënshkruar nga 15.276 pensionistë, ku natyrshëm është shprehur pakënaqësia e tyre me përmbajtjen e këtij projektligji.

Kjo kategori, që më së shumti janë të diskriminuar, deri më sot janë munduar që në mënyrë institucionale ta zgjidhin problemin e tyre, prandaj edhe duhet të sillemi ne, po në të njëjtën mënyrë.

Ju lutem se, nëse domi të themi që shteti i Kosovës jep pensione nga buxheti i vet, atëherë të bëjmë një kategorizim të pensionistëve. Pra të bëjmë edhe shkallën e përvojës, pastaj kategorinë e kualifikimit, të rangut të shkollës që e ka të kryer pensionisti, duke filluar nga shkolla fillore, shkolla e mesme, një kategori shkolla e lartë, një kategori universiteti dhe një kategori – pra vetë grada shkencore. Kjo diferencë le të shihet dhe le të dallohet.

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Sevdije Lama, e ka fjalën.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Edhe përkundër kësaj fryme politike të ditëve të fundit, megjithë atë diçka e pazakontë dhe me vlerë po lindë.

Të dielën, me datë 29 janar 2012 u mbajt Kuvendi themelues i Organizatës jo profitabile – Qendra Edukative Shkencore e Intelektuale Al-Kosmos me qendër në Gjakovë. Bashkë me shumë intelektualë pata nderi të jem pjesëmarrëse e kësaj iniciative kaq të rëndësishme, jo vetëm për qytetin e Gjakovës për edhe për gjithë rajonin, pasi që është e para e llojit të tillë.

Pa vazhduar më tutje, do ta bëj një falënderim të veçantë për ideatorin dhe themeluesin e saj, profesor doktor Jahja Koka, shkencëtar i përmasave botërore, me të cilin mburremi.

Qëllimi i Organizatës është:

- bashkëveprimi dhe bashkëpunimi i të gjithë studiuesve kudo që janë, në një organizatë të përbashkët;
- mbajtjen e lidhjeve në mes tyre;
- diskutimin e problemeve shkencore;
- organizimin e tryezave dhe konferencave shkencore;
- botimin e revistave të specializuara, e tjera.

Për t'i përmbushur qëllimet e saj, Organizata do të organizohet dhe veprojë në sesione.

- Sesioni i parë – Sesioni i astronomisë;
- Sesioni i nano-skopisë;
- Sesioni i energjive nga burime alternative e konvencionale;
- Sesioni i çështjeve mjedisore;
- Sesioni i vlerave pozitive kozmologjike.

Organizata, krahas punëve në sesione, do të veprojë edhe përmes formave përcjellëse, por nuk do të kufizohet vetëm në to, me aktivitete të poshtëshënuara:

- organizimi dhe mbajtja e konferencave shkencore;
- botimi i buletineve mujore, revistave shkencore, veprave shkencore;
- mbështetjen e veprimtarive studiuese, hulumtuese-shkencore, publicistike dhe formave tjera përmes një platforme elektronike, e cila do të mundësojë bashkëveprimin e potencialit intelektual në nivel kombëtar dhe botëror.

Shfrytëzoj rastin që përmes kësaj foltoreje të Parlamentit të Kosovës, tu bëj thirrje institucioneve të komunës së Gjakovës dhe institucioneve qeveritare që ta mbështesin këtë në çdo aspekt, në mënyrë që të vihet në funksion sa më shpejt që është e mundur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit deputete! Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti, le të përgatitet deputeti Shaip Muja.

SABRI HAMITI: Zotni kryetar i Kuvendit,

Zotni kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Deputetë – kolegë të nderuar,

Programi gjithëpërfshirës i Ahtisarit ose plani i Ahtisarit të cilin ne e kemi në diskursin tonë politik dhe kuvendor qëkaq vite, është pranuar në këtë Kuvend, në këtë institucion me një Vendim që i ka katër nene, dhe është mirë. Ai vendim i Kuvendi të Republikës së Kosovës është në fuqi edhe sot.

Është mirë të shihet, e të ri-shihet çka thotë, atje. Dhe atje thotë që ai “Plan është pranuar si i tillë duke bërë edhe lëshime të domosdoshme, në mënyrë që Kosova të shpallet shtet i pavarur e sovran dhe të kalojë në Këshillin e Sigurimit”. Kjo është shumë me rëndësi ta dini.

E sjell në vëmendje këtë, se shpeshherë harrohet të interpretohet teksti origjinal, çka ka ndodhur në Kuvend dhe të përdoret për diskutime të nivelit politik, që nuk do të duhej të përdorej.

E sjell në vëmendje këtë pikërisht tash, sepse ka dy ditë që ne gati me unanimitet morëm një vendim të ri të Kuvendit ku përpiqemi që ta kthejmë këtë sovranitet, ta ndërtojmë sovranitetin e brendshëm, duke pasur parasysh që edhe në konstruktin, edhe në konstitucionin e Kushtetutës së sotme që e kemi ne, me të cilën do të merremi shumë shpejt në bazë të Rezolutës së para dy ditëve, ekziston ky plan i Ahtisarit i cili në shumë ende është i dysishëm dhe po interpretohet dysishëm.

Sjell në vëmendje vetëm një element, me të cilin duhet kujdesshëm të merremi: Mënyra e zgjedhjeve, vlera e votës, tri shkallët e diferencimit të votës, mënyra e ndërtimit të Kuvendit – që i bie: mënyra e prodhimit të krejt pushtetit në Kosovë.

Pra, janë të dyja deklaratat – vendime të Kuvendit, le të merret edhe njëra edhe tjetra kur bisedojmë për tema të mëdha, për të cilat pretendojmë që kemi ndërtuar konsensus. Faleminderit! Sot, kaq!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë. Deputeti Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: I nderuar kryetar,

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Temën të cilën sot unë dua ta shtjelloj dhe informoj Parlamentin lidhet me çështjen e inkubatorëve të cilët janë të ndërtuar për edukimin e fermerëve në Republikën e Kosovës. Konkretisht për inkubatorin në komunën e Lipjanit, i cili është një investim prej 7 deri në 8 milionë euro nga Qeveria Norvegjeze dhe i cili inkubator ofron kapacitete jashtëzakonisht të nevojshme për zhvillimin e bujqësisë, procesimin e ushqimit, edukimin e fermerëve dhe të bujqve në Republikën e Kosovës.

Unë kam pas rast ta vizitoj para disa muajsh, apo para nja 6-7 muajsh dhe kam marrë informacione të mjaftueshme për qasjen jo shumë kompetente nga institucionet të cilat duhet të përkujdesen nga kjo për këtë inkubator, këtë shkollë e cila ofron mundësi jashtëzakonisht të rëndësishme për zhvillimin e bujqësisë në Republikën e Kosovës.

Për njohuri tuaja, atje ka edhe një konvikt i cili, do të thotë, është me mundësinë prej 16 veta dhe çka do të përfshinte dhe çka kishte në plan ai inkubator i cili ofron mundësi për edukimin se si trajtohet toka, si mbillet toka, cilat cilësi i ka toka dhe rendimentet të cilat i ofron. Tjetra është, se si trajtohen stallat, në çfarë mënyre trajtohet bagëtia dhe në fund fare, është edhe procesimi i ushqimit, edhe të atij bimor po edhe shtazor.

Unë, çka e kam vërejtur si të çuditshme, është se atje janë zhvilluar edhe katër kurikula nga Qeveria Norvegjeze, që do të thotë për planet edukative. Mandej ka shkuar Qeveria tjetër Gjermane – GTZ-ëja, SIDA Kanadeze, e po ashtu edhe së fundi tani Lux-Devolement dhe të krijojnë një përshtypje se donatorët nganjëherë kur nuk dinë ku të investojnë atëherë shkojnë dhe ri përsërisin edukime shtesë në institucione të cilat tani më i kanë ato kurikula dhe nuk përdoren nga institucionet.

Unë propozoj që Ministria e Bujqësisë ta marrë këtë qendër si Qendër referente në ndarjen e grandeve, sikur që është duke iu ndihmuar dhe është duke bërë një punë shumë të madhe tani më, por edhe donatorët tjerë që të kushtëzojnë edukimin e bujqve dhe fermerëve me marrjen e edukimit bazë, qoftë për edukimin si trajtohet toka, si trajtohet bagëtia e po ashtu edhe si trajtohet procesimi i ushqimit siç është përgatitja e qumështit, mishit dhe të gjitha tjerave. Pra, edhe Ministria e Arsimit të krijojë mekanizma dhe t'i vlerësojë ato kurikula e plan-programe dhe herë pas here në mënyrë monitoruese të kontrollojë kualitetin e edukimit...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Po, pasi po thotë Arbeni, edhe dy minuta ia jepni mundësinë për fjalë!

SHAIP MUJA: Faleminderit! Dhe, po ashtu Ministria e Arsimit të jetë bashkëpjesëmarrëse me këtë institucion. Pastaj Ministria e Punëve Sociale t'i vlerësojë kategoritë sociale të njerëzve, sepse kemi në Republikën e Kosovës bujq të varfër, pra që kanë tokë por janë të varfër. Pra, janë disa faktorë pse mbetet i varfër ai, është elementi edukativ, determinimi se çka duhet të bëjë ai dhe propozoj që të krijohet një bord, i kryesuar nga Komisioni për çështje të bujqësisë pranë Parlamentit të Republikës së Kosovës dhe të vizitohet ajo qendër bashkë me ministrinë përkatëse të cilat i përmenda dhe të vihet dorë që sa më shpejt të futet në edukimin e fermerëve, bujqve dhe të kushtëzohet nga Ministria e Bujqësisë për çdo grand i cili mund të merret nga grandet, qoftë ato jashtë buxhetit të Republikës së Kosovës po ashtu edhe nga buxheti i Republikës së Kosovës që bujqit ta kenë një edukim bazik, e jo t'i jepen mjete financiare e të mos ketë edukim dhe mos të dijë ai pastaj t'i shfrytëzojë ato.

Në këtë mënyrë, pra, Republika e Kosovës do të përfitojë në mënyrë indirekte jashtëzakonisht shumë, do të rritë shumë rendimente brenda prodhimeve bujqësore dhe ne nuk do të kemi nevojë pastaj t'i politizojmë çështjet e prodhimeve të jashtme, apo të brendshme. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Rexhep Selimi e ka fjalën. Regjia, në emër të Grupit është.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, për çështje që kanë të bëjnë me interesin e qytetarëve, më lejoni ta ngriti një çështje që vërtet është shqetësim i qytetarëve.

Kohëve të fundit, janë ngritur disa dilema. Janë bërë disa pyetje. Janë dhënë disa afate për përgjigje, madje ka pasur edhe konferenca për shtyp për këtë çështje. Por jo vetëm kaq.

Qeveria dhe SHIK-u kanë nxjerrë sërish agjentë në skenë për të bërë presione e shantazhe ndaj qytetarëve dhe personaliteteve.

Ne nuk flasim me gjuhë spiunësh, as agjentësh. Madje, nuk flasim fare me ta.

Por ne e kemi një mesazh për Qeverinë dhe për SHIK-un të cilët po bashkëjetojnë në pushtetin me vota të grabitura. Mjaft me këto shantazhe e me këto presione ndaj opinionit.

Nëse mendoni se mund t'i bëni dikujt presione e shantazhe me afatizime, e keni gabim. Nëse doni t'i frikësoni të tjerët me presione, prapë e keni gabim. S'ua ka frikën askush më!

Po nëse doni të mbani pushtetin e ta ndërroni me njëri-tjetrin postin e kryeministrit, prapë e keni gabim. Tashmë është tepër vonë për ju.

Por, tek e fundit, kush ua jep juve këtë të drejtë, kush jeni ju që angazhoni spiunë e agjentë për ta terrorizuar sërish opinionin, për të shantazhuar njerëz e personalitete, për të çuar mjegull dhe për të shmangur opinionin me ngjare dhe me shpifje të tilla?

Kush jeni ju që i jepni vetes të drejtë të shpifni e të ngrisni teoria e konspiracioni për të hutuar opinionin para saj që ju po bëni në dëm të vendit dhe të ardhmes së tij?

Pse e keni mashtruar opinionin se e keni shuar SHIK-un e tash dilni me aktivitete subversive ndaj të tjerëve?

Me mbarimin e luftës kemi menduar se do të përfundojë njëherë e përgjithmonë përfshirja e agjentëve në politikë dhe bërjen e politikës me anë të shërbimeve sekrete. Por, kjo shihet qartazi se nuk paska përfunduar.

Ngrisni dilema e ngrisni pyetje, duke e ditur se ato janë vërtetë shpifje. Janë shpifje që s'kanë të bëjnë asgjë me të vërtetën, por që kanë qëllim luftimin e së vërtetës. Ju me qëllim të shpifni e të trilloni dhe për ta krijuar një atmosferë shpifjesh që edhe e vërteta të duket e tillë para këtyre shpifjeve.

Në mesin e dilemave të ngritura nga ju kohëve të fundit, e keni ngritur edhe dilemën se kush pranoi e kush nuk pranoi ta vishte uniformën e UÇK-së. Se kush luftoi, e kush iu dorëzua Serbisë, se kush luftoi e kush tradhtoi kur ishte koha.

E nëse doni t'ua heqim dilemat ua tregoj se kush e veshi e kush e zhveshi uniformën e UÇK-së, madje edhe kush e përleu atë.

Mund t'ua tregoj një për një, cilitdo prej jush që pretendoni të jeni tregtarë të historisë e ta bleni e ta shisni historinë e luftës së UÇK-së, atëherë kur ju duhet juve. Por, sot duket që se kemi këtë kërkesë. Tani keni dal me kërkesa spiunësh të SHIK-ut.

Ne nuk i përgjigjemi SHIK-ut. Ne nuk ju përgjigjemi as ju. Ju duhet t'i përgjigjeni drejtësisë dhe qytetarëve. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Sot temperaturat jashtë janë -8°C, ndërsa gjatë orëve të natës kanë mbërri deri -22 °C. Po të kishit pas ju, që jeni përgjegjës kryesorë ndonjë anëtar të familjes të hospitalizuar në QKUK, ishalla nuk ndodh, a do t'ia kishit dërguar ndonjë nxehëse apo siç thotë populli ndonjë grejalicë për ngrohje.

Po më intereson cila është zgjidhja për pacientët që janë në spital, sepse edhe kryeministri edhe ministri i Shëndetësisë po thirren si reformatorë të sistemit shëndetësor, ndërsa pacientët po ngrihen. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Sali Asllanaj, e ka fjalën.

SALI ASLLANAJ: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që ta ngris një çështje të cilën e kanë ngritur me shqetësim qytetarët e fshatit Grejkoc në një tubim të cilin e kemi mbajtur më 7 janar së bashku me deputetin Bali Muharremaj.

Fjala është për çështjen e pronave të tyre, të cilat me ligjet e ish-Jugosllavisë viteve të viteve të 50-ta, iu janë konfiskuar me Ligjin mbi nacionalizimin, mbi tepricat e pronave apo Ligji mbi shpronësimet tjera.

Në këtë aspekt mendoj që tash ka ardhur një moment kur ato prona të menaxhuara nga Ndërmarrja Bujqësore Industriale - NBI Suhareka, do të jenë proces të privatizimit.

Ata e ngrisin këtë shqetësim, sepse do të komplikohen gjërat, janë procedurat e ndryshme gjyqësore dhe kërkojnë nga Kuvendi që të fillojë procedurat eventuale, sepse konsiderojmë që mundet ky Parlament të nxjerr ligje me të cilat do tua kthejë pronat ish pronarëve privatë.

Mendoj që neve, së bashku me zotin Muharremaj, na kanë bindur që kanë të drejtë dhe ju me siguri do të duhej të bindeni në një mënyrë të tillë dhe në këtë aspekt kisha propozuar që të futet në agjendën e Kuvendit një ligj i tillë.

E di që është shumë kompleks, shumë delikat, e di që ka komplikime të mëdha, por realisht do të duhej që të fillojmë ta qesim dhe ta kthejmë drejtësinë. Në këtë aspekt ndoshta e ka pas logjikën një sistem komunist atëherë kur iu kanë marrë ato prona, por në sistemet demokratike konsiderojmë që prona private është e shenjtë. Dhe, nëse është prona private e shenjtë në sistemin demokratik, atëherë të bëjmë diçka që atë pronë private ta respektojmë dhe t'ua kthejmë ish pronarëve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Koha është harxhuar. Tash Qeveria e ka fjalën. Fjalën e ka kryeministri zoti Hashim Thaçi.

HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që, natyrisht pas edhe Rezolutës të miratuar nga Parlamenti i Kosovës, pra Rezoluta e fundit, të shprehi zotimin tim përsëri për kryerjen e obligimeve që dalin nga kjo rezolutë dhe rezolutat tjera të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për konsolidimin dhe forcimin e shtetit të Kosovës dhe përmbylljen e procesit të mbikëqyrjes së pavarësisë. Dhe, në të njëjtën kohë, ne jemi në vazhden e përkushtimeve që i kemi marr edhe karshi komunitetit ndërkombëtar bashkarisht kohë më parë, dhe në këtë agjendë hyn edhe dialogu teknik në mes shtetit të Kosovës dhe Serbisë.

Insistimi dhe përkushtimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës ka qenë, është dhe do të mbetet implementimi i plotë i marrëveshjeve të arritura në mes shtetit të Kosovës dhe Serbisë për çështjet teknike sikur me vendet tjera fqinje, dialog teknikë ky i udhëhequr nga Bashkimi Evropian dhe i mbështetur plotësisht nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të gjitha vendet tjera që e kanë njohur Republikën e Kosovës. Angazhimi ynë do të jetë i plotë për progresin e dialogut duke punuar gjithmonë në forcimin dhe konsolidimin e shtetit të Kosovës. Pra Kosova do të vazhdojë të jetë e përgjegjshme në kryerjen e obligimeve që i ka marrë edhe nga Kuvendi i Kosovës, por edhe të obligimeve tjera ndërkombëtare.

Në kuadër të kësaj hyn edhe bashkëpunimi regjional. E di se ka pasur zhurma të ndryshme rreth kësaj problematike, por unë dua t'ju siguroj të gjithë juve, deputetë të nderuar, se qëndrimi i shtetit të Kosovës është shumë i qartë, është plotësisht në

përputhshmëri me Kushtetutën e Kosovës, me ligjet e Kosovës dhe me dokumentin e presidentit Ahtisari.

Dua t'ju siguroj juve, dhe të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës se Rezoluta 1244 për mua, Qeverinë e Kosovës, Kuvendin e Kosovës dhe popullin e Kosovës është e tejkalueshme, ndërsa shteti sovran dhe i pavarur i Kosovës është i përjetshëm. Ky është qëndrimi im, ky është qëndrimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Dëshiroj gjithashtu të theksoj se vendimet që i kemi marrë në Kuvendin e Kosovës do të respektohen në plotëni. Dokumenti i presidentit Ahtisari është dokument që e kemi mirëpritur dhe pranuar bashkarisht. Edhe në atë kohë kam deklaruar dhe deklaroj edhe sot se pavarësia e Kosovës ka qenë kompromisi ynë, prandaj duhet të punojmë bashkarisht të gjithë për hapat tonë të mëtutjeshëm për forcimin dhe konsolidimin e pavarësisë së Kosovës, por edhe hapat tonë të mëtutjeshëm integrujes. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër! Fjalën e ka zëvendëskryeministrja Edita Tahiri.

*(Ndërhyrje)*

Do të thotë, u krye! Atëherë, po vazhdojmë.

*(Ndërhyrje)*

Ishte para kohe! Tash, do të vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

## **2. Koha për pyetje parlamentare**

Në pajtim me nenin 45, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve, për Qeverinë është e kufizuar 60 minuta.

Deputeti për një mbledhje mund të parashtojë më së shumti 2 pyetje parlamentare. Ftoj deputeten Alma Lama, për pyetjen drejtuar ministrit Ramë Buja. Deputete e ke fjalën!

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Pyetja ime ka të bëjë në lidhje me çështjen e arsimit fillor.

Zoti ministër, Ministria juaj ka proklamuar një tjetër plan sipas të cilit në shtatorin e vitit të ardhshëm do të fillojë një projekt që do të integronte disa lëndë në një lëndë dhe po kështu mësuesit do të profilizoheshin. Pra, bëhet fjalë për projektin e teksteve të integruara.

Ky është një projekt i cili kërkon shumë punë dhe përgatitje, ndërsa Kosova aktualisht ka mungesa elementare, siç janë, për shembull: numri i pamjaftueshëm i klasave, mësuesë të pakualifikuar për lëndët e tyre, numër tepër i madh i nxënësve nëpër klasa, e tjera.

Prandaj, pyetja ime është: - Çfarë përgatitjesh konkrete ka bërë Ministria e Arsimit për ta realizuar një projekt të tillë, aq të madh dhe a është ky në përputhje me programin qeveritar, i cili së paku në planin afatmesëm parashihte projekte krejt të tjera për zhvillimin e arsimit. Sa para janë ndarë për hartimin e teksteve të integruara, siç i quani ju dhe kur do të fillojë ky proces? Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër e ke fjalën.

RAMË BUJA: I nderuari zoti kryetar,  
Zëvendëskryeministra,  
Ministra,  
Të nderuar deputetë,  
E nderuar deputete Alma Lama, se qenkan dy deputete Lama, faleminderit, shumë për pyetjen e bërë.

E para gjë që mund t'ju them, e kam një material që mund tua dorëzoj pastaj që ta kesh të shkruar, të saktësuar sepse është gjatë si përgjigje, por është çështje tjetër që është ky program i yni dhe ky kurikul është plotësisht në programin e Qeverisë, nuk është hiq në s'përputhje të saj, dhe unë po ua lexoj një pjesë të përgjigjes dhe pastaj pjesën tjetër më të përimtuar do ta merrni me shkrim.

Kosova e ka të krijuar një sistem arsimor që për nga struktura është kompatibil me sistemet e arsimit me vende me arsim më të avancuar në Evropë. Megjithatë, sistemi i arsimit në Kosovë tani ballafaqohet me vështirësi të cilat do të jenë sfidë e ardhshme për zbatimin me sukses të kurikulës së re dhe qasjes së re të reformave në arsim. Andaj, na duhet një përgatitje më e mirë para se të fillohet me zbatimin e plotë të korikulave të reja, metodologjisë, vlerësimit dhe burimeve të reja mësimore. Nuk ka të bëjë me shtatorin e vitit që vjen. Është pak më gjatë kjo punë dhe ne jemi në angazhim të plotë dhe jemi në një situatë të tillë për të vendosur një bazë të qëndrueshme të zbatimit që duhet siguruar.

Duhet siguruar hartimin e dokumenteve cilësore të korikulës në formimin e kornizës së kësaj kurikule, përgatitjen e plotë të sistemit shkollor dhe shkollave individuale për të marrë përsipër zbatimin e korikulës së re shtetërore, dhe ngritjen e kapacitetit të personelit drejtues dhe mësimdhënës në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të tyre.

Këtë zhvillim e kemi menduar në dy faza, jo vetëm në një fazë: zbatimin e fazës së parë e kemi menduar që do të bëhet zbatim pilot në mënyrë që të marrim informata për cilësinë dhe zbatueshmërinë e kësaj kurikule. Gjatë kësaj faze do të zhvillohen edhe dokumente përcjellës të zbatimit të kornizës së korikulës dhe udhëzues për zbatimin e korikulave, mjeteve dhe burime mësimore të cilat do të përcillen me aftësimin profesional të hartuesve të korrikulave, të mësimdhënësve e të drejtorëve të shkollave në tërë Kosovën.

Kjo fazë do të zgjatë së paku 2 vjet. Pilotimi do të zbatohet në disa shkolla që Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë i përcakton në bazë të kriterëve të parapara.

Gjatë kësaj faze duhet të bëhen trajnime për të gjithë mësimdhënësit që janë në shërbim aktualisht, të drejtorëve dhe stafit tjetër këshillëdhënës për zbatimin e këtyre kurikulave.

Do të bëhen trajnime edhe të mësimdhënësve para shërbimit, domethënë ata që janë në procesin mësimor ose të përgatitjes. Fjala është për programe të veçanta të Fakultetit të Edukimit, që e kemi në Prishtinë dhe në disa qendra në Kosovë.

Do të shfrytëzohet edhe mundësia për programe të veçanta për zbatimin e korikulës së re gjatë rikualifikimit të mësuesve, për ata që e kanë kryer shkollën e lartë 2 vjeçare, e tani e bëjnë 4 vjeçare.

Këtu kemi një tabelë që ju jep përgjigjen se si ka shkuar ky proces dhe si do të vazhdojë në 2010...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: A keni pyetje shtesë, deputete?

ALMA LAMA: E falënderoj ministrin për përgjigjen shumë të detajuar dhe në pamje të parë ky duket një plan shumë ambicioz, mirëpo duke pasur parasysh që Qeveria e Kosovës dhe ministria juaj përkatësisht prej kaq vitesh nuk ka arritur të hartojë një libër, një tekst abetareje të mirë dhe të pranueshëm, dhe më duket pak si ndërmarrje aventureske kjo që të filloni dhe të hartoni tekste të tjera të integruara që kërkojnë një investim të jashtëzakonshëm.

Prandaj, a mund të jeni pak më konkret, si do të realizohet kjo, sa kohë që keni dështuar në hartimin e një teksti të abetares? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër e ke fjalën.

RAMË BUJA: Alma, faleminderit, përsëri!

Po ne nuk kemi dështuar në asgjë. Nuk i kemi në përputhje dëshirat që i kemi për të realizuar arsimin në Kosovë, me mundësitë që kemi. Kjo është një e vërtetë.

Abetarja është realizuar mirë. Ne insistojmë që ta bëjmë një abetare edhe më të mirë për gjithë hapësirën gjeografike shqiptare, dhe do ta bëjmë. Ju garantoj se në shtator do ta fillojmë abetaren e re, dhe nuk do të kemi hiq kundërshtim për abetaret alternative që mund të jenë në qarkullim. Dhe për fazat tjera, unë po ju them ju dorëzoj me shkrim gjitha detaje për këtë.

Nuk është asnjë element dështak. Përkundrazi janë suksese të shumta, të mëdha që janë arritur dhe ju i dini, por megjithatë e keni detyrë dhe unë ju pranoj dhe e respektoj detyrën tuaj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Daut Haradinaj, pyetje për ministrin Agim Çeku. Ministri, na ka njoftuar që s'do të është këtu. A doni ta bëni pyetjen, deputet?

*(Ndërhyrje)*

Faleminderit! Deputetja Kimete Bytyqi, pyetje për ministrin Dardan Gashi. Ministri është këtu, deputete mund ta bëni pyetjen.

KIMETE BYTYQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Gjykata Supreme e Kosovës, me datën 16 janar 2012 përkohësisht e pezullon ekzekutimin e vendimit të Qeverisë së Kosovës, Nr. 02/ 46 të marrë me 2 nëntor 2011.

Ndërsa, në anën tjetër Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka deklaruar se në Republikën e Kosovës nuk ka asnjë operator të licencuar për nxjerrjen e rërës nga lumenjtë. Të gjithë kompanitë që kanë nxjerr rërë nga lumenjtë kanë qenë dhe janë ilegale.

Duke qenë kështu kërkoj nga ana juaj, zoti ministër të më përgjigjeni në pyetjen si në vijim:

- Cilat janë veprimet që do t'i merr Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor pas vendimit të Gjykatës Supreme?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën. Urdhëro, ministër Gashi!

DARDAN GASHI: I nderuar kryetar,

Kolegë të Kabinetit,

Deputetë të nderuar,

E nderuara deputete, zonja Kimete Bytyqi, ju falënderoj sinqerisht shumë për pyetjen!

Besoj se në parim nuk kam nevojë të sqaroj se për çfarë arsye Qeveria ka marrë vendime për ndalimin e përkohshëm të eksploatimit të lumenjve. Përveç ankesave permanente nga qytetarët që jetojnë përreth brigjeve të lumenjve që po shkatërrohen pamëshirshëm, inspektorët tanë, që në mënyrë intensive e kanë inspektuar situatën - kanë ardhur në përfundim se në ata pak lumenj që i kemi në Kosovë operojnë së paku 103 kompani eksploatuese nga të cilat, vetëm 1/3 ka qenë e licencuar.

Fatkeqësisht edhe kompanitë e licencuara kanë rezultuar të jenë brutalisht jashtë kushteve të licencave që posedojnë dhe si pasojë Ministria e Mjedisit ka i ka marrë 32 vendime për ndalimin e aktiviteteve, do të thotë, të eksploatimit dhe 28 padi kundërvajtëse.

Operatorëve ilegalë iu është sqaruar se duhet menjëherë ta ndërpresin aktivitetin, kurse atyre të licencuarve në bashkëpunim me KPMM-në, pra Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale iu janë tërhequr të gjitha licencat dhe lejet për operim.

Duke parë se aktivitetet shkatërruese nuk mund të ndalen me masa selektive, gjë që është tentuar edhe më herët, do të thotë që nga viti 2005, Qeveria e Kosovës në bashkëpunim

me 11 komunat përkatëse, në nëntor të vitit të kaluar, ka vendos që t'i pezullojë këto aktivitete prej 1 deri në 3 vjet në mënyrë që të konstatohen dëmet dhe të merren masa emergjente rehabilituese.

Më 3 janar këtij viti ky vendim ka hyrë në fuqi dhe në masë të madhe është respektuar nga operatorët, megjithëse në disa raste në bashkëpunim me KPMM-në dhe Policinë e Kosovës është dashur të ndërmerren masa ndëshkuese ndaj disa operatorëve.

Gjykata Supreme, befasishëm për Qeverinë, ka vendosur që të miratojë një ankesë të operatorëve me të cilën është pezulluar ekzekutimi i përkohshëm i vendimit të Qeverisë. Ministria dhe KPMM i kanë informuar operatorët se vendimi i gjykatës nuk nënkupton rifillimin e punës, pasi që asnjë kompani nuk posedon licencë për veprime të tilla si pasojë e anulimit të licencave më herët.

Gjyqi vetëm sa e kufizon përkohësisht Qeverinë për implementimin e masës së ndalimit deri në 3 vjet. Qeveria është në pritje të vendimit final nga gjykata. Gjykata në këtë rast nuk mundet të amnistojë në aktvendime, operatorët të cilët janë konstatuar ilegalë nga së paku 2 institucione kompetente shtetërore të Kosovës, pra MMP dhe KPMM.

Sa për informim KPMM, pra Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale është organ i themeluar dhe mbikëqyret nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe jo nga Qeveria.

E nderuara deputete,

Ministria dhe Qeveria në përgjithësi është e përkushtuar ta implementojë vendimin. Andaj ne kemi ushtruar ankimim në këtë vendim dhe kemi vazhduar me inspektimin.

Me rëndësi është të përmendet fakti që ndaj Vendimit të gjykatës kanë reaguar edhe 22 OJQ, pra në mbështetje të Qeverisë, deputetë të Parlamentit Evropian, Komisioni përkatës i Kuvendit të Republikës së Kosovës i përfaqësuar nga zoti Nait Hasani dhe kanë insistuar që të implementohen masat e Qeverisë për shpëtimin e lumenjve.

Unë ju siguroj se ne do të marrim gjithçka që të bindim Gjykatën për arsyet e Vendimit për ndalimin e shkatërrimit dhe jemi të vetëdijshëm se në këtë mënyrë Qeveria është duke i implementuar ligjet në fuqi dhe është duke e ruajtur interesin e përgjithshëm të popullit...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Deputete, a ke pyetje shtesë?

KIMETE BYTYQI: Jo, jo. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë! Faleminderit! Vazhdojmë.

Deputetja Lumnije Morina pyetje për ministrin Bedri Hamza. Deputete e ke fjalën.

LUMNIJE MORINA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Sindikata e pavarur e punëtorëve të ish-fabrikës së çelikut IMK - Ferizaj në vitin 2001 parashtrroi kërkesë - padi në Gjykatën Komunale të Ferizajt lidhur me ndërprerjen e kontratës së punës për 572 punëtorë dhe humbjen e pagave nga data 27 shkurt 1990.

Kjo kërkesë u miratua nga Gjykata Komunale e Ferizajt në favor të punëtorëve të Fabrikës së çelikut me 11 janar 2001.

Meqenëse, vendimi i Gjykatës Komunale të Ferizajt nuk u ekzekutua asnjëherë, sindikata e pavarur e punëtorëve të fabrikës së çelikut i vazhdoi kërkesat e veta për zbatimin e vendimit të Gjykatës Komunale të Ferizajt edhe në vitet 2002, 2005, 2006, 2007, 2008 e terë dhe në fund ajo i drejtohet me një kërkesë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës për vlerësimin e vendimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale të Ferizajt.

Më 17 dhjetor 2010, Gjykata Kushtetuese ka vendosur për kërkesën Nr. KI 08/09 të parashtruar nga Sindikata e pavarur e punëtorëve të fabrikës së tubave IMK - Ferizaj që vendimi i formës së prerë i Gjykatës Komunale të Ferizajt duhet të zbatohet nga autoritetet kompetente.

I nderuari, zoti ministër Hamza,

- Pse, edhe pas një viti të marrjes së Vendimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me punëtorët e Fabrikës së tubave të Ferizajt, ky vendim nuk po zbatohet?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuari, kryetar i Kuvendit!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

E nderuara deputete Morina, faleminderit shumë për pyetjen e parashtruar!

Më duhet t'ju them se Ministria e Financave nuk ka të bëjë me rastin në fjalë. Sidoqoftë, me këtë rast mund t'ju informoj se - rastin e ankesës së Sindikatës së pavarur të punonjësve të fabrikës së çelikut IMK- Ferizaj, e ka shqyrtuar Gjykata Komunale në Ferizaj, qysh në vitin 2002.

Më vonë Agjencia Kosovare e Privatizimit i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Komunale të Ferizajt C-Nr. 340/2001 të datës 11 janar 2002.

Gjykata Kushtetuese më 12 maj 2011 ka dhënë sqarimin, dhe ashtu siç shihet në pikën 10 të sqarimit të aktgjykimit në rastin Nr.KI 08/09 deceditivisht thuhet, dhe citoj:

“Sipas Ligjit për AKP-në shihet që AKP-ja është autoritet që administron ndërmarrjet shoqërore dhe që AKP-ja do t'i përmbush pretendimet e vlefshme të kreditorëve që kanë

të bëjnë me ndërmarrjet shoqërore nga mjetet e realizuara nga administrimi, shitja, transferimi ose likuidimi i ndërmarrjeve apo te aseteve të tilla. Pasi këto mjete të realizuara mbahen në mirëbesim dhe në të mirë të kreditorëve përkatës nga AKP-ja, AKP-ja mund të jetë e vetmja dhe tërësisht përgjegjëse për zbatimin e vendimit të Gjykatës Komunale të Ferizajt C Nr. 340/2001, të 11 janarit 2002.

Varësisht nëse edhe në çfarë mënyre paraardhësja e saj AKM-ja veproi gjatë këtyre 9 vjetëve të fundit lidhur me aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe respektimin e Ligjit të zbatueshëm”.

Nga pozicioni i ministrit të Financave nuk kam se çka t’i shtoj më tutje sqarimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës lidhur me këtë çështje. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A ke pyetje shtesë? Jo. Faleminderit! Deputeti Visar Ymeri pyetje për ministrin Besim Beqaj. Deputet, e ke fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Pyetja ime ka të bëjë me çështjen e procesit të privatizimit të distribucionit dhe furnizimit të KEK-ut.

Më 30 nëntor të vitit 2011 Komiteti i Privatizimit të Distribucionit dhe Furnizimit e ka aprovuar pakon tenderuese duke e shpallur kërkesën për ofertim për investitorët e para kualifikuar në procesin e privatizimit të distribucionit dhe furnizimit të KEK-ut.

Në pakon e aprovuar tenderuese janë këto dokumente:

- rregullat për ofertim;
- marrëveshja për shitblerje të aksioneve;
- marrëveshja për furnizim me shumicë me energji elektrike;
- marrëveshja për import; dhe
- marrëveshja për implementim.

Unë kam bërë kërkesë me 13 dhjetor të vitit 2012 për të marrë nga një kopje të këtyre dokumenteve, ndërkohë që Ministria juaj, zoti ministër, më është përgjigjur përmes letrës se këto dokumente janë draft dhe se nuk mund t’i marrim.

- A mund të na tregoni, pse nuk mund të kemi ne qasje në këto dokumente?

KRYETARI: Ministër e ke fjalën! Sigurisht e kishit fjalën për 2011?

BESIM BEQAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Deputet Ymeri, sigurisht që kërkesa ka ardhur më 13 dhjetor 2011, jo 2012, dhe ka ardhur nga zëvendësministri Ramadan Hasani dhe jo zëvendësministri Ramadan Avdiu,

sepse Ramadan Avdiu, siç është shkruar në pyetjen tuaj është zëvendësministër i Financave.

Megjithatë, më lejoni t'ju shpjegoj, se të gjitha dokumentet të cilat kanë qenë të një vitaliteti shtetëror, kanë kaluar nëpër debate të shumta publike. Janë dy dokumente themelore të cilat e udhëheqin këtë proces dhe ajo është marrëveshja, realisht është metodologjia e tarifave dhe dokumenti për modelin e tregut, të cilët kanë kaluar nëpër debate publike. Debatet publike kanë qenë të parapara për një muaj dhe këto debate me kërkesën e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik janë zgjatur edhe për 15 ditë të tjera. Pra, ka pasur debat publik rreth një muaj e gjysmë dhe fatkeqësisht asnjë rekomandim, asnjë çfarëdolloj komenti nga këta 1 muaj e gjysmë të debateve publike nuk ka pas. Dhe në ndërkohë debatet publike janë bërë edhe në kuadër të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Prandaj, lidhur me dokumentet të cilat ju po i referoheni, këto dokumente kanë kaluar tashmë 3 faza të përpilimit dhe komentimit.

Faza e parë është kur draft-dokumenti është përpiluar nga këshilltari i transaksionit dhe është dërguar për komente dhe përmirësime.

Faza e dytë ka filluar kur draft-dokumentet më pas janë plotësuar dhe përmirësuar nga ekspertë vendorë dhe ata ndërkombëtarë, të angazhuar në këtë projekt si Grup teknik i energjisë, i cili i përbën të gjitha institucionet të cilat janë pjesëmarrëse në procesin e përgatitjes së privatizimit të distribucionit. Pra, është: Zyra e Rregullatorit, KOST - KEK-u. Në këtë rast, Zyra e Rregullatorit, dua t'ju përkujtoj, se i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe deri tash janë mbajtur 10 takime ku janë diskutuar dhe shqyrtuar këto dokumente.

Pas përmirësimeve dhe adaptimeve të ndryshme, dokumentet kanë marrë edhe mbështetje dhe aprovim nga Komiteti qeveritar i privatizimit, duke i aprovuar këto dokumente si drafte finale.

Draftet finale pra janë aprovuar më 30 nëntor dhe iu janë dhënë dhe ofruar investitorëve për komentim, të cilët kanë pasur afat 1 muaj për t'i dhënë komentet e tyre.

Faza e tretë, e dokumentit, si dokument final vjen pas komentimeve të gjitha palëve, duke përfshirë këtu edhe investitorët, të cilët nuk kanë pasur vërejtje apo kërkesë të veçantë ndryshimi dhe në fund këto versione janë dërguar përsëri për aprovim në Komitetin qeveritar të privatizimit dhe janë aprovuar si dokumente finale, pra në këtë javë.

Në secilën dokument të pakos tenderuese, thuhet se dokumentet do të jenë publike konform Ligjit për qasjen në dokumentet publike.

Prandaj, konform Ligjit për qasje në dokumentet publike ne do të veprojmë dhe do t'i bëjmë publike atëherë kur na kërkon Ligji, do të thotë për qasje në dokumentet publike.

Asnjëherë, dokumentet në draft nuk mund të bëhen publike dhe kjo është shumë qartë e specifikuar me Ligjin për qasjen në dokumentet publike.

KRYETARI: Deputetë, a ke pyetje shtesë?

VISAR YMERI: Po, kryetar kam pyetje shtesë rreth kësaj.

Përgjigja që më është dhënë mua, është e vërtetë, domethënë në vitin 2011. Natyrisht s'mund të jetë më 13 dhjetor 2012 edhe se kam gabuar këtu. Mirë që e vure këtë në spikatë. Dhe është e vërtetë që nuk është Ramadan Avdiu, e kam gabuar edhe mbiemrin, por kjo nuk e ndërron çështjen.

Përgjigja që më është dhënë mua i është dhënë edhe shumë organizatave tjera joqeveritare, të cilat kanë filluar që të merren me çështjen e energjisë, privatizimit si dhe termocentralet.

Madje, ato e kanë ngritur këtë si çështje edhe në disa debate publike në të cilën keni qenë edhe ju të pranishëm. Kam qenë edhe unë i pranishëm.

Pra, e njëjta përgjigje iu është dhënë të gjithë atyre që i kanë kërkuar në fakt këto dokumente dhe mua më interesonte se si në një proces i cili po thuhet se do të jetë shumë transparent, transparenca po iu pamundësohet qytetarëve por edhe deputetëve, ata që janë të interesuar që të kenë qasje në këto dokumente edhe nëse janë drafte.

Pra, kjo po ia mundëson Qeverisë që sa herë flitet për këtë çështje t'i plasojnë disa informata ose t'i shesin disa të dhëna si informata, duke ia pamundësuar palës tjetër që t'i ketë të njëjtat informata dhe pastaj të debatohet...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: A keni koment?

BESIM BEQAJ: Për hir të korrektësisë, dua edhe njëherë të përmendi se të gjitha dokumentet të cilat janë kërkuar edhe nga shoqëria civile dhe e përmenda që kanë qenë nëpër debate publike dhe dokumentet të cilat janë për debat publik kanë kaluar nëpër debate publike dhe ne e kemi mirëpritur çfarëdolloj komenti, jo vetëm nga ju si deputetë, por edhe nga të gjithë përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Fatkeqësisht, në kohën kur është dashur të bëhen vërejtjet në dokumente nëpër debate publike nuk janë bërë.

Në ndërkohë, do të thotë ne jemi të obliguar konform Ligjit për qasjen në dokumentet publike dhe konform këtij ligji do të veprojmë.

Unë do të jem shumë i gatshëm në ftesën nga Komisioni parlamentar që të vi dhe t'i shpjegoj të gjitha dhe në kuadër të kësaj t'ju shpjegoj të gjitha detajet sa i përket

dokumenteve, por ne jemi obligues ndaj një ligji i cili thotë për qasjen në dokumentet zyrtare dhe ky ligj është ai të cilin do ta aplikojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pyetja e fundit. Deputeti Visar Ymeri, pyetje për ministrin Besim Beqaj.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Pyetja e dytë ka të bëjë me privatizimin e PTK-së. Siç e dimë të gjithë vendimi për privatizimin e PTK-së ka qenë pjesë e Ligjit për buxhetin për vitin 2011, pra është kontrabanduar përmes këtij ligji si njëri prej neneve aty.

Tash ky ligj natyrisht është shfuqizuar me Ligjin për buxhetin vitit 2012 të cilin e kemi në fuqi aktualisht. Kjo nënkupton që asnjë nen i këtij ligji më nuk është në fuqi.

Pyetja ime është: A do ta sillni vendimin për privatizimin e PTK-së prapë në Kuvend për miratim?

BESIM BEQAJ: I nderuari, kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Deputetë,

Deputet Ymeri,

Unë nuk e di si mund ta quaj dikush kontrabandim të një ligji i cili kalon nëpër Kuvendin e Kosovës me vota të deputetëve të cilët kanë marrë besimin e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Kjo do të ishte me të vërtetë e rëndë për ta thënë, por sido që të jetë është vlerësim i juaji personal.

Pra, kemi një ligj i cili e përlij vendimin e Qeverisë të datës Nr. 02-03 të datës 9 mars të vitit 2011 për privatizimin e PTK-së dhe ky vendim është miratuar nga Kuvendi i Republikës me hyrje në fuqi të Ligjit për buxhetin në vitin 2011 dhe vetë vendimi ka qenë aneks i këtij ligji. Pra, nëse flitet, do të thotë për nen, edhe vendimi ka qenë aneks i ligjit i cili iu ka ofruar të gjithë deputetëve.

Për të qenë më specifik, duhet theksuar e aprovimi është në referencë dhe në bazë të nenit 9.1. të Ligjit për ndërmarrje publike, dhe si i tillë ligjërisht nuk mund të konsiderohet ndryshe përpos si aprovim i vendimit të Kuvendit sipas kërkesave të nenit 9 të Ligjit për ndërmarrje publike.

Nga ana tjetër asnjë ligj i buxhetit nuk anulohet dhe aq më pak vendimi për privatizimi i aprovuar përmes nenit 4 dhe bazuar në nenin 9 të Ligjit për ndërmarrje publike me përjashtim, kur specifikisht kërkohet ndryshe me ndonjë ligj apo vendim të Kuvendit.

Për ta përmbyllur nuk ka bazë e kërkesë ligjore dhe as nevojë praktike që të aprovohet edhe një herë vendimi i cili është aprovuar një herë nga ky Kuvend dhe është valid.

KRYETARI: Faleminderit! A ka pyetje shtesë? Urdhëro, deputet!

VISAR YMERI: Ministër! Unë thash që vendimi për privatizimin e PTK-së është kontrabanduar përmes ligjit. Nuk është kontrabanduar ligji.

Vendimi, edhe sipas Ligjit për ndërmarrje publike, do të duhej të vinte në Kuvend si i ndarë, të debatohej dhe të votohej si vendim i cili pastaj natyrisht do ta kishte jetëgjatësinë e një vendimi të miratuar në Kuvend ndaras nga ligjet, se vendimet nuk mund të bëhen pjesë e ligjeve, e veçanërisht jo të ligjeve të cilët e kanë afatin e caktuar, siç është Ligji për buxhetin.

Pra, Ligji për buxhetin, i vitit 2011 është shfuqizuar nga ai për vitin 2012. Nuk jemi më duke punuar me ligjin e vitit 2011. Kjo është evidente, dhe kjo nënkupton që secili nen i tij tash më nuk është në fuqi. Ndërkohë që, ju po thoni, që vendimi është në fuqi. Si është vendimi në fuqi, kur ka qenë pjesë e një neni? A ka qenë si dokument shtesë a aneks, mirëpo nuk është miratuar si vendim i ndarë.

Pra, a do ta sillni a nuk do ta sillni?

KRYETARI: Urdhëro, ministër e ke fjalën!

BESIM BEQAJ: Faleminderit!

I nderuari deputetë,

Neni 4, shprehimisht thotë se “privatizimi i PTK-së bëhet në bazë të Ligjit për ndërmarrje publike, në bazë të nenit 9.1 të këtij ligji”, prandaj nuk mund ta quajnë në asnjë rrethanë kontrabandim të një vendimi, i cili në mënyrë të shprehur të qartë thuhet se bëhet në bazë të nenit 9.1. të Ligjit për ndërmarrje publike dhe Ligji për ndërmarrje publike është ligj afatgjatë. Nën një.

E dyta, Ligji për buxhetin, si i tillë, në provizionin e fundit e thotë shumë qartë që ky ligj, do të thotë ka efekte, vija vjetore për ndarjet buxhetore të cilat parashihen, por nuk parasheh që çfarëdolloj neni tjetër të eliminojë çfarëdo vendimi i cili është marrë konform ligjeve tjera të cilat janë sjell në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Prandaj, unë konsideroj që, një vendim i Kuvendit të Kosovës konform ligjit i cili është në fuqi dhe i cili nuk është anuluar me asnjë vendim tjetër - është valid.

KRYETARI: Ju e dini që ky nuk është debat. Pyetjet kanë përfunduar.

Pyetjet e deputetëve, që nuk morën përgjigje në disa seanca, butoni Buletin e Kuvendit, sipas nenit 45, paragrafi 11 të Rregullores së punës.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

### **3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26 janar 2012**

A ka vërejtje në Procesverbal?

Meqenëse nuk ka vërejtje, konstatoj se Kuvendi miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 26 janar 2012.

Prezent kemi 63 deputetë.

Pika katër:

#### **4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimet e shoqërisë informatike**

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në parim.

Ftoj ministrin për Zhvillim Ekonomik, zotin Besim Beqaj, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë Projektligjin. Ministër e ke fjalën!

BESIM BEQAJ: I nderuari kryetar i Kuvendit,  
Kabinet Qeveritar,  
Të nderuar deputetë,  
Ju paraqes për aprovim Projektligjin për shërbimet e shoqërisë informatike.

Ky projektligj është ndryshim i Ligjit për shërbimet e shoqërisë informatike numër 2005/02 L-23, që ka dalë si nevojë për harmonizimin me legjislacion evropian, respektivisht direktivat e Bashkimit Evropian, po edhe si rrjedhojë e zhvillimit shumë të shpejtë të shërbimeve të shoqërisë informatike, që bazohen në përdorimin e teknologjisë informatike dhe komunikuese si dhe shfrytëzimin e pagesave elektronike dhe të shërbimeve të tregtisë elektronike.

Shërbimet e shoqërisë informatike janë të gjitha ato shërbime që zakonisht ofrohen me pagesë, në largësi me anë të mjeteve elektronike dhe me kërkesa individuale të shfrytëzuesve të shërbimeve.

Nëpërmjet këtij ligji vendoset baza juridike për bërjen e transaksioneve nëpërmjet internetit, qoftë për mallra, e po ashtu edhe për shërbime. Me këtë projektligj, dokumentacioni në formë elektronike përcaktohet juridikisht i barabartë me dokumentacionin tradicional të paraqitur në formë të letrës, për të lehtësuar shërbimet elektronike.

Qëllimi i këtij ligji është lehtësimi i shërbimeve elektronike në shitblerjen që e bëjnë konsumatorët nëpërmjet internetit, shërbimet elektronike dhe ato financiare, ofrimin e shërbimeve qeveritare nëpërmjet të teknologjisë informative, si dhe aplikimi i nënshkrimit elektronik. Nëpërmjet aplikimit të nënshkrimit elektronik, të gjitha transaksionet të cilat do të bëhen on-line dhe në kohë reale, bëhen në mënyrë të sigurt. Domethënë baza ligjore, që siguron ky projektligj për nënshkrime elektronike, mundëson shkëmbime dhe pagesa elektronike në mënyrë shumë të sigurt, duke shtuar besimin e konsumatorëve dhe atyre që ofrojnë shërbime në rrjet dhe shërbime të komunikimeve elektronike.

Ky projektligj do të zbatohet për cilin do lloj informacioni dhe në formën e mesazhit të të dhënave, përveç rasteve siç janë në vijim:

- Kontratat, që krijojnë apo transferojnë të drejtën për pasurinë e patundshme, përveç të drejtave të qerasë;
- Kontratat, që me ligj, kërkojnë përfshirjen e gjykatave, të autoriteteve publike ose të atyre profesionale, që ushtrojnë autoritet publik;
- Kontratat për garancinë e dhënë dhe për sigurinë kolaterale dhe për personat që veprojnë për qëllime jashtë fushës së tyre tregtare të biznesit apo profesionit, dhe
- Për kontratat që rregullohen me ligjin familjar dhe ligjin për trashëgiminë.

Projektligji, po ashtu, parasheh edhe rregullimin e çështjeve, që kanë të bëjnë me zbatimin e kërkesave ligjore, për mesazhet e të dhënave, komunikimet e mesazheve të dhëna, themelimin dhe kërkesat informatike, komunikimet komerciale, kontratat e bëra në mënyrë elektronike, përgjigjen e ofruesve të shërbimeve të ndërmjetme, kontratën në distancë, fatura në formë elektronike, e tjerë.

Gjithashtu, projektligji parasheh edhe mbrojtjen e sistemeve të shërbimeve të shoqërisë informatike, e cila ka për qëllim që të përmirësojë bashkëpunimin nëpërmjet organeve gjyqësore dhe autoriteteve tjera kompetente, duke përfshirë këtu policinë dhe shërbimet e specializuara për zbatim të ligjit nëpërmjet harmonizimit të dispozitave të Kodit penal të Kosovës, në pjesën e veprave penale kundër sistemeve informatike dhe transferit të të dhënave.

Projektligji për shërbimet e shoqërisë informatike vendos një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore që do të jetë në harmoni me direktivat e Bashkimit Evropian dhe sipas *acquis communautaire*. Këtë e dëshmon edhe ekspertiza ligjore e Ministrisë së Integrimeve Evropiane, e cila përkujdeset për harmonizimin e legjislacionit vendor, me atë të Bashkimit Evropian.

Ky projektligj përmban në vete pjesë të transpozuar nga direktivat e Bashkimit Evropian për tregtinë elektronike, për nënshkrimet elektronike, direktiva për pagesat elektronike.

Lidhur me këtë, gjatë hartimit të amendamenteve të këtij projektligji është shfrytëzuar edhe asistencë teknike nga TAIEX-i, nga ekspertë të kësaj lëmie, të cilët përfaqësohen përmes Komisionit Evropian.

Projektligji për shërbimet e shoqërisë informatike, ndër të tjera, parashikon që Ministria të krijojë dhe mirëmbajë regjistrin dhe databazën e ofruesve të shërbimeve, të certifikimeve të themeluara në Kosovë, në mënyrë që të mund të bëhet mbikëqyrja e autoriteteve certifikuese dhe të krijohet një nivel i besueshmërisë për shfrytëzimin e shërbimeve të ofruara nga ofrues të certifikuar. Në këtë kontekst të mbikëqyrjes së ofruesve të certifikimit, të themeluar në Kosovë, Ministria do të definojë çështjet që kanë

të bëjnë me: autoritetin dhe funksionin e autoritetit mbikëqyrës, si dhe çdo çështje tjetër të nevojshme për autoritetin mbikëqyrës, i cili mund të jetë një organ publik apo privat.

Përveç tjerash, nëpërmjet këtij projektligji, krijohen edhe kushte të përshtatshme për të gjithë ata që e shfrytëzojnë teknologjinë informative dhe komunikuese si biznes primar, por edhe për ata që këtë teknologji e shfrytëzojnë si mjet për të bërë biznes. Domethënë, nëpërmjet këtij projektligji ndjeshëm kontribuohet në përmirësimin e ambientit për të bërë biznes në Kosovë.

Në këtë rast, i nderuar kryetar, të nderuar deputetë,  
Duke pasur parasysh rëndësinë e materies, që ky projektligj rregullon dhe nevojën për plotësimin e kornizës ligjore në fushën e shërbimeve të shoqërisë informatike si parakusht për një zhvillim të qëndrueshëm dhe me perspektivë të shërbimeve të shoqërisë informatike, ju rekomandoj që në parim ta miratoni këtë projektligj. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti)*

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka kryetari i Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zoti Pajaziti!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar Kabinet Qeveritar,

Kolegë deputetë,

Komisioni funksional për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri, më datë 25 janar 2012, e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për shërbimet e shoqërisë informatike, në përputhje me nenin 56 dhe pas shqyrtimit në parim të Projektligjit për shërbimet e shoqërisë informatike, kemi vlerësuar se projektligji i plotëson kushtet e parapara me nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandojmë Kuvendit për miratim në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Radha është e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Buzhala e ka fjalën!

BERAT BUZHALA: I nderuar kryesues,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Ky projektligj e mbulon njërën prej fushave në zhvillimin më të hovshëm, jo vetëm në Kosovë, por edhe jashtë saj.

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji do të krijohen rrethana shumë më të favorshme dhe mundësi për zhvillimin e tregtisë elektronike dhe do të lehtësohet jashtëzakonisht jeta e qytetarëve, andaj, Grupi Parlamentar i PDK-së e miraton në parim këtë projektligj dhe kontributin e tij do ta japë në komisionin funksional dhe në komisionet tjera të përhershme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, zonja Sahatqija.

TETUA SAHATQIJA: Faleminderit, kryesues!

Edhe ne në Grup Parlamentar e kemi analizuar këtë ligj dhe mendojmë se zhvillimi i hovshëm i teknologjisë informatike në botë, e po ashtu edhe në Kosovë, ka ndikuar në kërkesë apo nevojë që këto çështje të definohen dhe të rregullohen përmes ligjeve.

Edhe Kosova, si vend në të cilin ekzistojnë bizneset, ku pjesa më e madhe e njerëzve apo afaristëve janë njerëz të ri, me dije në elektronikë dhe duke u bazuar në zhvillimin e teknologjisë dhe në Kosovë ka e-commerce, apo tregti elektronike, pagesat kryhen në mënyrë elektronike dhe do të duhej që të ketë edhe prokurim elektronik, të respektohet nënshkrimi elektronik dhe bashkë me këtë edhe mbrojtja e këtyre të dhënave, të cilat përmes rrjetit apo në mënyrë elektronike dalin në përdorim.

Kjo fushë, më herët është mbuluar me Ligjin për shërbime të shoqërisë informative, apo Ligjin 02-L/23 të vitit 2005, por duke pas parasysh zhvillimet më të reja nga kjo datë, atëherë si duket është bërë kërkesa që ky ligj plotësisht të hiqet dhe të vjen një ligj i ri, e jo të bëhet plotësimi apo ndryshimi i ligjit.

Në memorandumun shpjegues flitet edhe për ligjin për komunikime elektronike, gjë që është pak e çuditshme, sepse ne nuk e kemi marr atë ligj, nuk e dimë a ekziston apo jo dhe si duket do të vjen në të ardhmen, po atëherë do të kishte qenë mirë ta ketë shpjegimin që ai do të vjen në të ardhmen, që do ta mbulojë një pjesë të kësaj fushe.

Në materialin, të cilin e kemi marrë shihet se nga Ministria për Zhvillimin Ekonomik, parashihet një ndikim buxhetor prej 34.886 euro në vitin e parë, e pastaj për 10.000 euro tjera çdo vit. Aty shpjegimi është që do të jetë i punësuar edhe një zyrtar, ndërsa në anën tjetër shohim prej Ministrisë së Financave se nuk ekziston mundësia e punësimeve tjera dhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve, kjo çështje nuk është e definuar. Atëherë, të presim pra, prej ministrisë që të na tregojë se në çfarë mënyre do të mbulohen këto shpenzime, apo kostoja shtesë.

Në anën tjetër, shohim që ky ligj është në fakt një grumbull apo një bashkim i Ligjit për e-commerce, të ULCITRAL-it, të direktivave të ndryshme të EU-s, të rekomandimeve të Komisionit për Kodin Etik të pagesave, e tjera. Por, mendojmë që në disa dispozita, në disa nene ka edhe përsëritje dhe do të duhet të bëhet një konsolidim i tekstit të ligjit. Do të thotë edhe një ristrukturim i dispozitave të ndryshme në këtë ligj, duke u nis edhe prej nenit 1 dhe nenit 2.

Në anën tjetër, shihet që një pjesë bukur e madhe e ligjit, ka të bëjë me kontrata dhe në njërën anë vjen të nënkuptohet, që mund të ketë një dyfishim të kompetencave me Ligjin për marrëdhëniet detyimore në Kosovë, me Kodin Penal dhe me Ligjin për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik.

Prandaj, mendoj që në punën, të cilën do ta ketë Komisioni, do të duhej që me të vërtetë me kujdes ta analizojmë këtë ligj, të shohim se çka mund të bëhet në përmirësim, në një ristrukturim edhe në definimin e kompetencave, në mënyrë që të njëjtat kompetenca mos të rregullohen me disa ligje, gjë që nuk mund të sjell lehtësi, por mund të vështirësojë zhvillimin të fushës së e-commerce, të tregtisë elektronike, e tjera.

Më duhet të them përsëri, se gabimet gjuhësore, sikur në ligjet tjera edhe këtu vazhdojnë që të përvidhen nëpër nenet e ligjeve të ndryshme dhe do të duhej, që së paku Kuvendi të tentojë që të përmirësojë dhe të eliminojë, së paku në masë të konsiderueshme ato gabime gjuhësore, të cilat paraqiten.

Kontributin e mëtejshëm do ta japim në komision dhe ne në parim e përkrahim këtë projektligj.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputetja Gashi.

ALBANA GASHI: Edhe Lëvizja Vetëvendosje, do ta mbështesë në parim këtë projektligj. Vërejtjet dhe rekomandimet tona do i japim në Komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së, zoti Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!  
Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës e mbështetë Projektligjin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Koalicioni Kosova e Re, zoti Mustafa e ka fjalën!

MUHAMET MUSTAFA: I nderuari zotëri kryesues,  
I nderuar kabinet qeveritar,  
Të nderuar deputetë,  
Grupi parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re e përshëndet propozimin e këtij Projektligji, duke e konsideruar atë si një infrastrukturë ligjore, për të rregulluar procedura që sigurojnë digjitalizimin dhe informatizimin e shërbimeve qeveritare dhe shërbimeve biznesore.

Me këtë ligj ne bëjmë një hap cilësor për të fituar më shumë tipare të shoqërisë informatike, e që ka një rëndësi shumë të madhe për zhvillimin social dhe ekonomik.

Efektet pozitive të këtij ligji do të jenë në uljen e kostos së transaksioneve biznesore dhe në rritjen e aftësisë konkurruese të ekonomisë së Kosovës, e po ashtu, që është me të njëjtën rëndësi, edhe për rritjen e transparencës dhe efikasitetit të institucioneve të Kosovës, dhe në këtë drejtim jam i bindur që do të ndikojë edhe në uljen e korrupsionit.

Brenga ime e vetme është, sa është shoqëria jonë në këtë moment e përgatitur që të zbatojë në tërësi këtë ligj, meqenëse hyn në fuqi pas 15 ditësh.

Prandaj, nevojitet një angazhim, me të vërtetë i të gjitha subjekteve, që i tangon ky ligj, që me aktet e nevojshme nënligjore dhe rregulloret sa më shpejt ky ligj të zbatohet në sa më shumë segmente që i rregullon. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar SLS, deputetja Kostiq.

BISERKA KOSTIĆ: Zahvaljujem, gospodine potpredsedniče!

I parlamentarnga grupa Samostalne liberalne stranke je razmotrila Nacrt zakona o službi informatičkog društva. Podržaćemo nacrt zakona u načelu. Svoje primedbe i preporuke daćemo Komisiji. Zahvaljujem.

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar „6+“, zoti Demiri.

RASIM DEMIRI: Zahvaljujem, predsedavajući!

Parlamentarna Grupa „6+“ je analizirala i razmotrila Nacrt zakona o službi informativnog društva. Daćemo svoj doprinos i u načelu podržavamo ovaj zakon. Zahvaljujem.

KRYESUESI: Faleminderit!

Radha është e deputetëve.

Sipas paraqitjes, zoti Demolli e ka fjalën!

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuari kryesues i Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit Qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Duke pasur parasysh marrëdhëniet shoqërore, të cilat rregullohen me këtë draft-ligj, respektivisht objektin apo problematikën e trajtuar në të, e që është jashtëzakonisht e re, dhe domethënë se ka filluar të trajtohet vetëm në këto kohët e fundit, është e pritshme dhe e natyrshme që edhe ky draft-ligj të përcillet me lëshime dhe dobësi të caktuara.

Me këtë rast do t'i theksoja disa prej sugjerimeve lidhur me çështje të caktuara, të këtij draft-ligji.

Së pari, do të filloja nga vetë emërtimi i ligjit. Si ligj për shërbimet e shoqërisë informatike, ndonëse në emërtim haset shprehja “shoqëri informatike”, në përmbajtjen e ligjit e as në përkufizimet e tij nuk haset ndonjë sqarim lidhur me këtë shprehje. Andaj, vetvetiu shtrohet pyetja, prej nga ideja për një emërtim të këtillë të këtij ligji.

Së dyti. Më tutje në nenin e parë të këtij ligji, flitet për qëllimin dhe fushëveprimin e ligjit, duke theksuar se ky ligj përcakton dokumentacionin në formë elektronike, juridikisht të barabartë me dokumentacionin tradicional, të paraqitur në forma të letrës për të lehtësuar shërbimet elektronike. E në vazhdim, numëron sferat në të cilat shfrytëzohet ky dokumentacion, duke filluar nga shitblerja, shërbimet bankare, qeveritare, financiare, e të tjera.

Por, nga dispozitat e këtij ligji shihet se nuk është fushëveprimi i këtij ligji vetëm dokumentacioni elektronik. Por, janë edhe subjektet që e shfrytëzojnë një dokumentacion të këtillë si dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. E po ashtu, edhe mbrojtja e sistemeve të shërbimeve informatike apo elektronike si dhe ndëshkimi apo sanksionimi i veprimeve, me të cilat cenohen këto marrëdhënie. Andaj, mirë është që në këtë nen, konkretisht në nenin 1, të përcaktohen edhe këto sfera të fushëveprimit të këtij ligji.

Më tutje. Ky draft-ligj përmban në nenin 2 një numër të madh të shprehjeve, që janë përkufizuar me qëllim që të qartësohen, si për lexuesin ashtu edhe për zbatuesin e këtij ligji. Mirëpo, nga leximi i disa prej tyre, fitohet përshtypja se në vend të qartësimi të shprehjeve ato aq janë të pakuptimta sa që edhe shkaktjnë konfuzion.

Kështu për shembull, për shprehjen “konsumator” jepet ky përkufizim. Me “konsumator” nënkupton person fizik, që vepron për qëllime jashtë tregtisë, biznesit apo profesionit të tij.

Pra, nga leximi i këtij përkufizimi, unë vërtetë e kam të vështirë të kuptoj se çka është konsumatori. Athua mjafton për të, të thuhet se vepron për qëllime jashtë tregtisë, biznesit apo profesionit.

Po ashtu, edhe shprehja “tregtari” nuk është përkufizuar apo definuar në mënyrë të qartë.

Vërejtja tjetër e imja, ka të bëjë me nenin 64, i cili emërtohet “qasja ilegale në sistemet informatike”. Konkretisht në paragrafin 4 të tij theksohet, citoj: “Kur kryhet vepra penale nga paragrafi 1, 2, 3 të këtij neni, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim, jo më pak se një vit.”.

Mirë është që të përcaktohet limiti i ultë dhe i lartë i dënimit me gjobë, pra prej cilës shumë deri në cilën shumë mund t’i shqiptohet gjoba dhe gjithsesi edhe për dënimin me burg, përveç limitit të ultë duhet të që të caktohet edhe limiti i lartë, sepse këtu theksohet vetëm limiti i ultë, “jo më pak se një vit burg”. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Selmani e ka fjalën!

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përsëndetje për ministrat dhe deputetët!

Për Grupi Parlamentar, prof. Mustafa e dha vlerësimin që e përkrahë Projektligjin për shërbimet e shoqërisë informatike.

Duke marrë parasysh se në mandatin e kaluar ne e kemi kaluar një ligj për krimin kibernetik dhe çështja e zhvillimit të informatikës ka shkuar shumë lartë, sa që është dashtë të vijë edhe ky projektligj për shërbimet e shoqërisë informatike.

Mund të them se ligji krijon rrethana shumë të mira për zhvillim elektronik, por njëkohësisht në paragrafë, të cilët i ka dhënë Qeveria në këtë projektligj, mund të thuhet se ndoshta do të ishin akoma masat edhe më të rrepta në rast se ndërhyr dikush në

çështjet e vlerësimeve të ligjeve apo ligjshmërisë së dokumentacioneve elektronike të kompanive a kujt do tjetër.

Duke i marrë parasysh rrethanat e zhvillimit të legjislacionit të Bashkimit Evropian, atëherë duhet të ecet edhe me legjislacionin e Kosovës në të njëjtën rrugë.

Këtu kisha me e potencia se çështja e zbatimit të këtij projektligji është, shumë e qartë, dhe se nuk do të varet nga vetëm Ministria e Zhvillimit Ekonomik por njëkohësisht do të varet edhe nga Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit, në të cilën do t'i vijë në ndihmë edhe Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Integritetit Evropian, për arsye se në të ardhmen Kosova pretendon që të jetë pjesë e BE-së dhe një shtet që do të jetë pjesë e BE-së, e atëherë duhet të ketë edhe një infrastrukturë të tillë ligjore.

Shpresojmë, që gjatë amandamentimit të këtij projektligji s'do të ketë shumë problem, për arsye se kornizat janë dhënë mjaftë qartë dhe shihet mjaft qartë se cilat do të jenë masat të cilat duhet t'i marrin autoritetet e veçanta në këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Deshishku, e ka fjalën!

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete,

Projektligji për shërbimet e shoqërisë informatike është njëri prej dokumenteve më të rëndësishëm për rregullimin e raporteve dhe krijimin e sigurisë në komunikimin elektronik. Njëkohësisht, përmes tij avancohen dhe bëhen më të sigurt edhe raportet komerciale, të krijuara përmes komunikimit apo kontaktit me mjete elektronike.

Në përgjithësi, e përkrah këtë projektligj me disa vërejtje që kryesisht kanë të bëjnë me stilin dhe gjuhën që përdoret aty.

Projektligji vuan nga strukturat e ndërlikuara të fjalive, të cilat në disa raste krijojnë konfuzion apo janë të paqarta. Si ilustrim po përmendi nenin 7 pika 1, ku thuhet: “Përveç nëse jepet ndryshe nga rasti në këtë ligj, ose në ndonjë ligj në Kosovë, personit i kërkohet, që të krijojë ose të mbajë dokumentin në formën e vetë origjinale”. Atëherë një kërkesë e tillë është e plotësuar nga mesazhi i të dhënave: “nëse...” Është krejtësisht e pakuptueshme pjesa e parë e fjalisë, “përveç nëse jepet ndryshe nga ose në këtë ligj”.

Apo, në nenin 10, pika 1, 1, citoj: “Çdo ulje nga ose fletëkufizim në lidhje me çdo transaksion ndërkufitar, këtu kjo është e nevojshme për një nga arsyet në vijim:”. “Çdo ulje nga...”, fjalë e paqartë, nuk kuptohet çka domethënë “çdo ulje nga”.

Të tilla fjali ka përplot, prandaj është e duhur që paraprakisht këtij ligji t'i bëhet një reduktor gjuhësor, në mënyrë që ai të jetë më i qartë dhe më i kuptueshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Përfaqësuesi i Qeverisë, e ka fjalën! Zoti Beqaj!

BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kabinet Qeveritar,

Unë ju falënderoj të gjithëve për të gjitha komentet tuaja dhe për mbështetje në parim të këtij projektligji, për të cilën u deklaruat.

Lidhur me pyetjet, të cilat u ngritën lidhur me koston, është e vërtetë që ka një kosto e cila do të mbulohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, nga buxheti vetjak të cilin e ka.

Dhe, kolizioni me ligjet tjera, të cilat u ngritën, në këtë ligj, sikurse edhe të gjitha ligjet tjera i procedojmë në Zyrën Ligjore të Kryeministrit, e cila themelon një grup punues dhe i cili i harmonizon të gjitha legjislacionet aktuale, që të mos ketë kolizion me ligjet tjera.

Prandaj, këtë fazë ligji e ka kaluar dhe unë dua të besoj që Zyra Ligjore, do të thotë, është e kujdesshme në nivel të mjaftueshëm, për të mos lënë kolizione të tilla.

Lidhur me Ligjin për komunikimet elektronike, të dy ligjet kanë shkuar në Zyrën Ligjore përnjëherësh. Mirëpo, për shkak të një trajtimi, që është dashur të bëhet në mes të Ministrisë së Administratës Publike, ai ligj ka mbetur për më vonë për t'u përkujdesur pak më shumë dhe dje ka kaluar në Qeveri dhe do të vijë shumë shpejtë në Kuvend.

Lidhur me zbatimin, besoj që të gjitha ministratë relevante, të cilat janë të përfshirë në këtë, e kanë tashmë të përgatitur formën e zbatimit të këtij legjislacioni.

Ndërsa sa i përket qartësimeve në determinimet e termave deri te ato se cilat do të duhej të ishin dënimet dhe përmirësimet teknike, ne do të punojmë së bashku me të gjitha grupet parlamentare dhe komisionet, me të cilat së bashku do ta bëjmë një ligj, i cili do të vijë në versionin e leximit të dytë si ligj shumë më i kompletuar.

Unë ju falënderoj edhe një herë, për të gjitha. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për shërbimet e shoqërisë informatike.

Në mbledhje janë 62 deputetë. Lus deputetët, që të përgatiten për votim dhe votojmë tani!

Faleminderit! Konstatohet se me 51 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për shërbimet e shoqërisë informatike.

Kërkohet nga Komisioni Funkcional dhe Komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Pika e pestë e rendit të ditës është:

### **5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për turizmin dhe shërbimet turistike**

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

Ftoj zëvendëskryeminstren dhe ministren e Tregtisë e Industrisë, zonjën Mimoza Kusari Lila, që pranë deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë Projektligjin.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRJA MIMOZA KUSARI-LILA:** Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

Më lejoni që shkurtimisht të paraqes qëllimin, rëndësinë, fushën e rregullimit dhe përmbajtjen e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03-L/168 për turizmin dhe shërbimet turistike.

Sfera e turizmit paraqet njërën ndër sferat e rëndësishme të ekonomisë, ndërsa dihet se ne shumë vende turizmi paraqitet edhe si industri ekonomike. Aktualisht, kjo sferë është e mbuluar me Ligjin numër 03-L/168 për turizmin dhe shërbimet turistike.

Ky projektligj është në harmoni të plotë me aktet ligjore të Bashkimit Evropian në këtë fushë dhe do të plotësojë disa mangësi, të cilat kanë ekzistuar me ligjin në fuqi.

Me këtë projektligj rregullohen marrëdhëniet ndërmjet institucioneve publike dhe subjekteve tjera në republikën e Kosovës, në kuptimin e kompetencave, që kanë të bëjnë me turizmin, marrëdhëniet ndërmjet personave fizikë dhe juridikë, vendës apo të huaj, që ushtrojnë veprimtari turistike.

E veçanta e këtij projektligji është themelimi i Organizatës nacionale turistike të Kosovës, institucion ky i cili do të përfaqësojë nivelin qendror rajonal, komunal dhe komunitetin e biznesit dhe do të merret me promovimin e turizmit në Republikën e Kosovës. Themelimi i Organizatës nacionale turistike të Kosovës do të mundësojë edhe anëtarësimin e Kosovës në shumë mekanizma të ngjashëm ndërkombëtarë dhe rajonal dhe do t'i ofrojë mundësi komunitetit të biznesit për pjesëmarrje në vendimmarrje për projektet e promovimit të turizmit.

Kjo organizatë formohet me qëllim që të bëjë të mundshëm zhvillimin e promovimit të produkteve turistike, në harmoni me strategjinë e zhvillimit të turizmit të Kosovës si në nivel të Republikës së Kosovës, ashtu edhe në atë rajonal dhe lokal.

Formimi i Organizatës nacionale të turizmit do të përcaktohet me akte nënligjore, sikur parashihet në nenin 23 të Projektligjit.

Më duhet të qartësoj se krijimi i kësaj organizate nuk shërben për centralizimin e pushtetit në fushën e turizmit nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Përkundrazi, Organizata nacionale e turizmit do të shërbejë si një urë lidhëse për të gjithë aktorët relevantë, që ndërlidhen me fushën e turizmit në vend, duke përfshirë këtu edhe sektorin privat dhe qeverisës në Kosovë.

Organizata nacionale e turizmit, gjithashtu, do të luajë rolin e udhëzuesit të burimeve zyrtare të informacionit turistik, për t'u shërbyer aktorëve të turizmit, zyra për vizitorë, Odës ekonomike dhe organizatave të ngjashme, që ofrojnë informacione të lira, të sakta dhe të paanshme udhëtimi për publikun dhe gjithashtu për komunitetin e biznesit, duke filluar nga organizatat joqeveritare, agjentët e udhëtimit, operatorët turistik dhe objektet e akomodimit.

Për më shumë, ky projektligj do të duhej të përmirësonte konkurrencën e industrisë së turizmit kosovar në tregjet ndërkombëtare, të ndërtojë një imazh dhe vend të veçantë për Kosovën, si dhe të rrisë kapacitetet e industrisë për vetë rregullim.

Veprimtaria e Organizatës nacionale turistike të Kosovës në pika të shkurtra përfshinë:

- Ngritjen e shërbimeve të përgjithshme të turistëve,
- Ngritjen e kualitetit dhe shërbimeve tjera komplementare,
- Njohjen e vendeve turistike,
- Zhvillimin e njohurive të rëndësishme në fushën e turizmit, efektet shoqërore dhe ekonomike në ruajtjen e produktit turistik,
- Ngritjen e kapaciteteve të infrastrukturës dhe mundësinë e informimit të turistëve/

Deri në vitin 2015, ky projektligj nuk parasheh implikime buxhetore për buxhetin e Kosovës. Parashikohet që deri atëherë ONT-ja do të duhej të ketë arritur konsolidimin për vetëfinansim dhe si një linjë e veçantë buxhetore nga Qeveria, duke mos përjashtuar bashkëfinansimin nga donatorët, qysh nga iniciimi i formimit, pra, nga aktualisht miratimi i propozimit.

Po ashtu, ndryshimet dhe plotësimet e këtij projektligji do të krijojnë kushte të favorshme për ushtrimin e veprimtarive turistike me konkurrencë të mirëfilltë në tregun turistik për zhvillimin, promovimin e ekonomisë turistike dhe integrimin e saj në asociacione turistike ndërkombëtare.

Përpos kësaj, avancimi i infrastrukturës ligjore në këtë fushë ka ndikimin e vet praktik në identifikimin dhe eliminimin e pengesave, të cilët e dëmtojnë rëndë jo vetëm zhvillimin e turizmit, por edhe zhvillimin ekonomik në përgjithësi.

Të nderuar deputetë, duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij projektligji, dhe duke pasur parasysh nevojën e avancimit të infrastrukturës ligjore në lëmin e turizmit, ju rekomandoj që ta shqyrtoni dhe miratoni këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja ministre! Fjalën e ka kryetari i Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti Pajaziti!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!  
Kabinet Qeveritar,  
Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri në bazë të nenit 56, në mbledhjen e mbajtur të datës 25 të muajit që shkoi, e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për turizmin dhe shërbimet turistike dhe pas shqyrtimit, ka vlerësuar se projektligji i plotëson kushtet e parapara me nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, deputeti Berat Buzhala.

BERAT BUZHALA: Faleminderit, zoti kryesues!  
Ministra,  
Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i PDK-së e ka shqyrtuar këtë projektligj, të cilin e konsideron të një rëndësie të jashtëzakonshme.

Dihet që në Kosovë ka pasur probleme të tmerrshme me organizimet hoteliere, me pasqyrimin dhe me prezantimin e pikave turistike dhe vendeve turistike në vendin tonë.

Prandaj, konsiderojmë se me këtë projektligj do të arrihet një standardizim dhe Grupi parlamentar i PDK-së e miraton në parim këtë projektligj dhe kontributin e tij do ta japë në komisionin funksional. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, zoti Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, i nderuari kryesues!  
Të nderuar ministra,  
Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e ka shqyrtuar këtë projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 3-L/168 për turizëm dhe shërbime turistike.

Do të mundohem që të flas sa më shkurt, dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, do të paraqes disa vërejtje, komente dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj.

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për turizëm dhe shërbime turistike jep disa zgjidhje më të qëndrueshme dhe që i përputhen më shumë aktualitetit në këtë fushë të ekonomisë.

Megjithatë, edhe ky propozim, përkatësisht Projektligji ka mangësi, si në zgjedhjet që i ofron por edhe në mënyrën e formulimit.

Unë po filloj nga neni i fundit, që është risia më e madhe që i sjellin këto ndryshime.

Neni 23 parasheh themelimin e Organizatës nacionale turistike të Kosovës. Ai i ka vetëm dy pika, dhe po i citoj:

- “1. Me këtë ligj themelohet Organizata nacionale turistike e Kosovës.
2. Organizimi i funksionimit dhe fushëveprimi i saj rregullohet me akt nënligjor.”.

Grupi parlamentar i LDK-së vlerëson se nuk mjaftojnë vetëm këto dy pika për të themeluar një organizatë kaq me rëndësi. Askund nuk përkufizohet së paku nevoja, qëllimi, rëndësia, përgjegjësitë dhe kompetencat e saj.

Propozoj, që në mënyrë të detajuar të sqarohen çështjet për të cilat fola më lartë, veçanërisht kur kemi parasysh se akti nënligjor mund të pësojë ndryshime të shpeshta, dhe sipas nevojës momentale. Dhe, njëkohësisht, nëse përgjegjësitë, kompetencat dhe autorizimet e agjencisë nuk përkufizohen me këtë ligj, atëherë mbetet e paqartë se ku do të bazohen aktet nënligjore, që do të nxirren.

I kam edhe disa vërejtje në përmbajtjen e disa neneve të këtij projektligji.

Vërejtjet e përgjithshme

Me ligj e as me projektligj nuk janë përcaktuar qartë zonat e veçanta, si për shembull: Shpella e Gadimës, Bjeshkët e Rugovës, Shala e Bajgore, Kulla në Dukagjin e të tjera. Cili do të ishte kontributi i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë ndaj komunave ku janë këto zona, si në ligj ashtu edhe në projektligj mungon përkufizimi për turizmin kulturor?

Vërejtje rreth përkufizimeve

Neni 2, pika 1.21, turist, nënkupton personin fizik i cili vizitor ose shfrytëzues i shërbimeve turistike, që qëndron të paktën për një natë jashtë vendbanimit të tij. Duhet të ndryshojë, meqenëse qëndrimi së paku për një natë jashtë vendbanimit të tij nuk i jep statusin e turistit. A mund të jetë turist ai që kalon një natë te miku apo te shoku i tij? Propozoj të përkufizohet si vizitor i cili qëndron në një ndalesë me destinacionin turistik, së paku për një natë apo një konsumator i shërbimeve turistike.

Përkufizimet në ligj, pika 1.17-restorant, citoj: Objekti i cili ofron shërbimet e furnizimit me ushqim, ku qëllimi kryesor është shitja e ushqimit për konsum, jashtë ose brenda lokalit. Propozoj që pas ushqimit, të shtohet edhe fjala: “pije”, se nuk mund të ketë vetëm ushqim pa pije.

Në nenin 8 që ka të bëjë me ndryshimin e nenit 15, thuhet: “Në rast se kur Agjencia turistike, organizatore organizon paketa turistike brenda ose jashtë vendit, është e detyruar të angazhojë një përfaqësues turistik, për t’i mikpritur udhëtarët në vendin e arritjes. Fjala: “mikprit”, është e pakuptueshme dhe nuk mund të gjendet në fjalorin e gjuhës shqipe, prandaj propozoj se kjo fjalë të zëvendësohet me fjalën “mirëpritur” ashtu që një përfaqësues turistik për t’i mirëpritur udhëtarët në vendin e arritjes.

Në neni 20 të ligjit, definon rasti kur Agjencia nuk përmban përgjegjësi për mos përmbushjen e programit. Propozoj të hiqet pika 2.2, kur thuhet se Agjencia turistike, organizatore nuk mban përgjegjësi nëse lëshimet e paparashikuara dhe të paevitueshme, i ngarkohen personit të tretë, i cili nuk ka marrë pjesë në realizimin e shërbimeve të kontraktuara.

### Arsyetimi

Agjencia duhet të ketë kujdes dhe të bartë përgjegjësi edhe për angazhimin e palës së tretë si pjesë e programit, ta ketë parasysh kompetencën, seriozitetin dhe profesionalizmin e saj.

Në nenin 28/a, definohet turizmi balenar. Kam dilemën nëse ky term është i saktë, a është shqip, çfarë lloj turizmi nënkupton? Kjo fjalë nuk gjendet në fjalorin shqip-shqip.

Neni 16, që ka të bëjë me nenin 31 të Ligjit, paragrafi 2/b, të shënohet edhe një pikë e re, të vendosë në vend të dukshëm shenjë për ndalimin e pirjes së duhanit, ku nuk e përcakton ligji.

Në nenin 35, paragrafi 2, përcakton gjobë nga 250 deri në 750 euro. Dallimin prej 500 euro, kush përcakton këtë dallim, inspektori në bazë të bindjes? Ky dallim krijon hapësirë për individualizëm apo për negociim rreth masës së dënimit. Këtë mund të keqpërdorë dhe të vijë deri te korrupsioni. Njësoj vlen edhe për neni 36, paragrafi 2, dënimi 150 deri në 450 euro. Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për turizëm dhe shërbime turistike, Grupi Parlamentar i LDK-së, në parim përkrah dhe kontributin e vet do ta japë në komisionet parlamentare dhe fton deputetët ta votojnë këtë projektligj. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Aliu e ka fjalën.

**LIBURN ALIU:** Të nderuar deputetë,

Është hera e tretë që në Kuvend po trajtohet një ligj që ka të bëjë me turizmin. Pra dy vitesh në Kuvend është shfuqizuar Ligji për veprimtarinë hoteliere dhe turistike, i cili nuk mund të thuhej se ishte ligj i keq. Madje edhe pse ishte i punuar dhe sipas standardeve dhe direktivave evropiane, u shfrytëzua dhe erdhi në fuqi Ligji për turizmin dhe shërbimet turistike të cilin tash po e trajtojnë, pra për plotësim e ndryshim.

Trajtimet në Kuvend të ligjit, të ligjeve në përgjithësi dhe nga ana tjetër mos zhvillimi i turizmit, ngecja dhe mosfunksionimi i një sistemi të rregullt që zhvillon turizmin, të lë

të mendohet se ligjet po vijnë e po trajtohen pa u konstatuar fare ngecjet dhe problemet e ligjeve.

Si të konstatohen problemet me ligjet dhe mosfunksionimi i tyre, kur ato në fakt as që zbatohen dhe tek ne është shndërruar, pra në një dukuri trajtimi, e ritrajtimi i ligjeve e në ndërkohë që ato nuk zbatohen. Kjo sikur do që të lihet përshtypja se fajin e ka ligji jo i mirë e jo ekzekutivi. Pra, vijnë gjithmonë ligje njëri pas tjetrit, e të cilët bazohen në modelet e ndryshme, merret pra model një vend tjetër, pastaj ndërrohet ai dhe merret model një vend tjetër dhe jo të bëhen e të trajtohen e të ndryshohen ligjet në bazë të përvojave dhe në bazë të praktikave që ne i kemi. E që ligji aktual të konsiderohet jo funksional dhe të vijmë në përfundim që duhet plotësuar e ndryshuar, duhet të kemi përvojën e mosfunksionimit të tij. E ligji aktual në fuqi për të qenë funksional, është dashur që të nxjerrën 15 akte nënligjore, 11 nga Ministria e Transportit dhe Industrisë dhe 4 nga kuvendet komunale e aktet nënligjore zakonisht do të duhej që të nxjerrshin në aftë prej 6 muajsh dhe po i bie që këto akte nënligjore kanë vonesë më tepër se 18 muaj.

Tani ligjet në fuqi duam pra t'i ndryshojmë 23 nga 42 nenet e tij, ndryshim tepër i thellë për faktin se po bëhet nga hamendja dhe jo nga praktikat në terren. Të mos harrojmë që mos nxjerrjen e akteve përkatëse nënligjore, pasojë e këtyre mos nxjerrjes së akteve përkatëse nënligjore, Kosova është i vetmi në rajon si vend, i cili nuk ka cicerone turistike, shoqërues turistik dhe animatorë turistik të certifikuar e as shërbime të certifikuara që ata do të duhej t'i ofronin.

Është e qartë se ligjet bëhen jofunksionale në mungesë të legjislacionit subsidiar, pra të akteve nënligjore. Ekspertë të turizmit që trajtuan edhe këtë ligj konsiderojnë se në mungesë të këtyre akteve, pothuaj 60% e këtij ligji konsiderohet si i pazbatueshëm e kur kësaj i shtohen edhe mungesat dhe kompetencat profesionale dhe përvojave konkrete në Ministri, do të mund të themi që ky ligj nuk është provuar fare në praktikë.

Thjesht, një inspektor turistik, në mungesë të akteve nënligjore nuk do të mund të zbatojë mbi 80% të punëve të kontrollit inspektues në fushën e hotelierisë dhe turizmit e këtu përfshihen mbi 70 kundërvajtje të ndryshme që gjobiten nga 90 deri në 9000 euro. Boshllëku ligjor, pra mungesa e këtij legjislacioni subsidiar modern turistik, pastaj dobësia institucionale dhe niveli i ulët i zbatimit, kanë nxitur dhe ka zhvilluar në njëfarë mënyre abuzimet fiskale, ekonominë informate, korrupsionin dhe krimin ekonomik.

Këto dukuri janë pengesa të mëdha të zhvillimit të turizmit dhe investimeve të brendshme apo edhe të huaja në turizëm. Pra kanë kaluar 8 vite nga aprovimi i Ligjit të parë për turizmin dhe dy vite nga fuqizimi i ligjit aktual në Kosovë dhe në Kosovë nuk kemi asnjë objekt të akomodimit siç janë hotelet e motelet e që është i kategorizuar dhe për këtë, po ashtu jemi të vetmit në rajon.

E për sa i përket projektligjit, pra plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit aktual, ajo që e bënë skandaloze është pikërisht është neni i cili e parasheh themelimin e Organizatës

nacionale turistike dhe kompetencat e saj pasi e përcakton me akte nënligjore, pra bëhet fjalë për nenin 23.

Pra, kur tani kemi të bëjmë për ndërtimin e një organi të veçantë, siç është bërë kështu dukuri e përgjithshme te ne të ndërtohen këshilla të pavarura dhe komisione të pavarura, këto atëherë nuk i marrin modelet e huaja, jemi model në veti, pasi që në praktikën e vendeve tjera në botë organizatat e tilla themelohen në bazë të ligjeve dhe detyrat dhe kompetencat e tyre, caktohen me ligj e jo me akte nënligjore.

Ndoshta diçka të tillë të ngjashme do të mund të gjenin, eventualisht në ndonjë vend totalitar. Në vendet e Evropës, vetëm organizata nacionale turistike nuk themelohet me ligj të veçantë, por organizatat e ndryshme turistike në çfarëdo niveli, qoftë ato komunale dhe regjionale deri te këto të nivelit kombëtar, siç është Organizata nacionale turistike, përcaktohen me një ligj dhe definohen qartë kompetencat dhe detyrat e tyre.

Këtu Ministria kërkon që me ligj të vetëm, vetëm ta quajmë të themeluar këtë organizatë dhe pastaj kompetencat t'ia lëmë pastaj akteve nënligjore që do të duhej të themeloheshin.

Së pari nuk duhet lënë kompetencat e tilla në dorë vetëm të Ministrisë, pasi që ka Kuvend dhe ne nuk jemi shtet totalitar, do të mund t'i diskutojmë këto çështje në Kuvend. Kudo nëpër botë diskutohen deri në hollësi çështjet e ndryshme në Kuvend. Dhe së dyti, po e shohim qartë se kur vjen puna te aktet nënligjore Ministria është tejet inaktive dhe rrjedhimisht edhe kjo organizatë rrezikon të mbetet ose në letër ose të ndërtohet për aq sa mund t'i plotësojë eventualisht nevojat e dikujt për ta punësuar dike siç është bërë shprehi kohëve të fundit që të ndërtohen vazhdimisht organe, trupa të tilla ku vetëm punësohet dhe ato mbesin jofunksionale.

Mos të harrojmë se turizmi është një segment tejet i rëndësishëm për zhvillimi e ekonomisë së vendit, prandaj duhet trajtuar seriozisht. Turizmi gjeneron vende të reja pune dhe gjeneron veprimtari të reja zhvillimi. E sa seriozisht Qeveria e merr turizmin, mjafton të thuhet se në programin qeverisës 2011-2014, për turizmin nuk është thënë asnjë fjalë e vetme. Pra, mos puna e Qeverisë, nuk duhet përpjekur që të mbulohet me propozime për ndryshime të ligjeve, por thjesht me punë konkrete në zbatimin e tyre.

Edhe përkundër dyshimeve që i parashtruam, ne do ta votojmë ligjin dhe do të përpiqemi që edhe ky ligj të jetë sa më i mirë dhe natyrisht me shpresë se do të vihet në funksion. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Ramadani e ka fjalën.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar i Aleancës e përkrah Projektligjin, jo vetëm se është i mirë projektligji, por edhe prezantimi i ministres ishte i mirë. Ne e ftojmë ministren që Organizata Nacionale e Turizmit të themelohet sa më shpejtë në mënyrë që kjo punë të jetë po ashtu edhe transparente. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar, Kosova e Re, deputetja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Koalicioni për Kosovën e Re ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për turizëm dhe shërbime turistike.

Duke marrë parasysh se ne edhe gjatë prezantimit të ministres u tha se e kemi projektligjin i cili është në fuqi, mirëpo duke pasur parasysh organizimet të cilat bëhen për çështjen e turizmit dhe të hotelërisë, është paraqitur nevoja në bazë direktivave të BE-së që të formohet Organizata Nacional- Turistike e Kosovës. Dhe çështja e themelimit të kësaj organizate, do të thotë se duhet të ketë ndryshim dhe plotësim të projektligjit i cili është edhe sot në shqyrtim të parë dhe duke marrë parasysh se të gjitha kompetencat tjera të cilat janë në këtë projektligj, janë nga ligji i kaluar. Shpresojmë dhe besojmë që shumë shpejt të formohet ky organ i cili është brenda Departamentit të Hotelërisë dhe çështjet shumë të imëta në këtë projektligj për ndryshim dhe plotësim, të cilat ndoshta as nuk duhet të bisedojë brenda seancës plenare, duhet të harmonizohen brenda Komisionit Parlamentar.

Koalicioni për Kosovën e Re, e përkrahë projektligjin dhe shpresoj që do të gjejë zbatueshmëri në të ardhmen. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Nga SLS, deputetja Kostiq.

BISERKA KOSTIĆ: Zahvaljujem gospodine pod-predsedniče!

I Parlamentarna Grupa samostalno liberalne stranke razmotrila Nacrt zakona o turizmu i turističkim uslugama. Smatramo da je ovaj zakon od velikog značaja za Kosovo, ali posebno za srpsku zajednicu koja živi na mestu najvećeg turističkog potencijala u Brezovici, kao i na mestima koji omogućavaju razvoj sve popularnijeg verskog turizma.

Nacrt zakona prilično precizno definiše odnos u turizmu kao privrednoj grani. Međutim, smatram da je ovaj zakon trebao da uvede Instituciju turističkih organizacija čiji je osnivač opština kao i centralne turističke organizacije.

Sušтина ovih institucija je da se turistički potencijali instituciono razviju, da su podrška turističkim radnicima i privatnim preduzećima u turizmu i naj efikasniji način za pružanju turističkih informacija. U zemljama regiona postoje posebni zakoni o turističkim organizacijama koji definišu ovu oblast, kako u planu rada Skupštine nema posebnog Zakona o turističkim organizacijama, smatram da imamo šansu da do drugog

čitanja, popravimo predloženi nacrt ili iniciramo usvajanje posebnog zakona o lokalnim i centralnim turističkim organizacijama.

Svakako, Parlamentarna grupa samostalne liberalne stranke, podržaće nacrt zakona u načelu. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Nga Grupi Parlamentar “6+”, zoti Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Ju faleminderit!

I nderuar nënkryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar “6+”, e ka analizuar dhe shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për turizmin dhe shërbimet turistike dhe duke pasur parasysh se është një ligj i rëndësie të veçantë dhe i cili i plotëson të gjitha kriteret e nevojshme procedurale si dhe ato të legjislacionit të Bashkimit Evropian, Grupi Parlamentar “6+” e përkrah në parim, ndërsa kontributin do ta japim përmes komisionit përkatës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Radha është e deputetëve.

Deputetja Bakalli.

AURORA BAKALLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Turizmi në Kosovë, lirisht mund të thuhet se është në gjendje shqetësuese për faktin se nuk kemi qasje në të dhënat e numrit të turistëve që vizitojnë Kosovën, nuk bëhet promovim i mjaftueshëm i potencialeve turistike kosovare jashtë vendit, nuk bëhen investime serioze në resurset turistike, madje edhe për ata turistë të rrallë të cilët e vizitojnë Kosovën, nuk ka pika apo zyra informative të cilat do t’u ofronin informacionet e nevojshme dhe broshurat e harta turistike të Kosovës.

Edhe projektligji të cilin jemi duke e shqyrtuar, shumë më tepër rregullon çështjet e shërbimeve turistike, gjegjësisht agjencioneve turistike, pra që edhe vendorët të orientohen jashtë Kosovës, për turizëm se sa që jep hapësirë për një bazë ligjore për krijimin e politikave të mirëfillta të zhvillimit të turizmit në Kosovë, gjë që konsiderojmë se është hendikep i madh i këtij ligji.

Edhe pse disa nga nenet përmendin llojet e ndryshme të turizmit, ato thjesht na servohen si përkufizime të këtyre llojeve e jo si sugjerime për mënyrën e zhvillimit dhe implementimit të tyre. Madje, një organizatë e vetme që parashihet në këtë ligj e ashtuquajtura Organizata Nacionale Turistike e Kosovës, e cila do të mund të jepte një shpresë të vogël në planifikimi e strategjive për zhvillimin e turizmit në Kosovë, vihet në dyshim ekzistenca e saj për shkak të implikimeve shtesë buxhetore, siç thuhet në opinionin financiar të bashkëngjitur këtij projektligji nga Ministria e Financave.

Duke u nisur nga gjithë kjo, lehtë mund të vijmë në përfundim se turizmi në drejtim të themelimit të organeve të cilat do të punonin në përpilimin e një vizioni për të, nuk ka përkrahje nga Qeveria e tanishme. Rrjedhimisht, kjo na shpie të kuptojmë se në Kosovë ende nuk kemi një planifikim të mirë për zhvillim ekonomik, për faktin se njëri nga burimet potenciale të zhvillimit të Kosovës, përveç bujqësisë, padyshim që është edhe turizmi. Vërejtje tjetër është se shumë shpesh në ligj përsëritet urdhërimi për pagesën obligative të tatimeve, gjë që gjatë leximit të ligjit, të bën të dyshosh se mos pagesa e tatimeve për këto subjekte ekonomike në Kosovë është e shpeshtë kur dihet se çdo person juridik aktiv, ka obligim ligjor të pagesës së tatimeve, prandaj e shoh të paarsyeshme përsëritjen kaq të shpeshtë.

Si konkluzion, ne si Lëvizje për Bashkim, konsiderojë se ky plotësim-ndryshim i paraparë nuk është i mjaftueshëm për krijimin e kushteve të përshtatshme në vendosjen e bazave të shëndosha për turizëm në Kosovë, të cilat në vazhdim, do të mundësonin një rritje të këtij sektori dhe shndërrimin e tij në gjenerues të zhvillimit ekonomik. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!  
Zoti Zharku e ka fjalën.

LUTFI ZHARKU: Ju faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Zonja ministre,

Në parim e përkrah të gjitha iniciativat të cilat kanë të bëjnë me thjeshtimin e procedurave me liberalizimin e tregut e tjera, megjithatë kisha pasur dëshirë t'i shpreh disa vrojtime të mia sa i përket dy çështjeve. E para është çështja e klasifikimit dhe kategorizimit të objekteve, me ligjin e ri ju nuk e përmendët, me propozimet e juaja ju i keni paraparë që kategorizimi të jetë jo i obliguar.

Unë po kthehem deri te një studim i cili është bërë në vitin 2009, nga ana e Komisionit Evropian, i cili ka pasur për analizë shumicën e licencave në shumë fusha, përfshirë edhe turizmin, ndër to është përendur që në shumicën, një pjesë të vendeve të Bashkimit Evropian, normalisht që kategorizimi nuk është i obliguar, por nuk është, të themi një përgjithësim apo një veti që duhet të jetë edhe te ne jo i obliguar. E para, është, te ne besoj se duhet të vazhdojë të jetë i obliguar për shkak të mbrojtjes së konsumatorit. Ne jemi dëshmitarë të asaj se kemi nëpër të gjitha, anë e kënd Kosovës, hotele të cilat i mbajnë yje, tre yje, katër yje, pesë yje, në realitet ato yje kurrkush as nuk ua ka dhënë me ligj as nuk ka pasur kurrfarë komisioni që i ka, thjeshtë të jetë në diskrecionin e kompanive.

Unë besoj se për shkak të mbrojtjes të konsumatorit, duhet të mbetet edhe një kohë të caktuar, kategorizimi të jetë një obligim i cili duhet të bëhet. Është çështje e juaj se si e bëni përmes një komisioni të përbashkët me bizneset apo Ministria, megjithatë për një periudhë kalimtare besoj se duhet të mbetet.

Në anën tjetër, ka mospërputhje në dispozita, përkundër asaj se parashihni kategorizimin jo të obliguar, me dispozita tjera parashihet një obligim, them në nenin 16, thuhet se është obligative vendosja e shenjave të kategorizimit. Nëse nuk është e obliguar, nuk duhet të jetë as obligative vendosja e shenjave.

Po ashtu, me një nen tjetër thuhet se Ministria bën mënyrë periodike rikategorizimin, që do të thotë se kemi një kontradiktë në mes neneve. Në anën tjetër derisa praktikisht është në fuqi një udhëzim i tetorit të vitit 2007, mbi kategorizimin e objekteve hoteliere, që fatkeqësisht nuk është implementuar që një vit e gjysmë dhe po më duket se është zgjedhur pamundësia e implementimit, është zgjedhur një rrugë që pasi nuk po mund ta implementojmë, bile po e heqim edhe si obligim ligjor.

Sa i përket çështjes tjetër, te Organizata Nacionale Turistike u thanë shumë gjëra, megjithatë besoj se është e panevojshme themelimi i kësaj organizate, së pari në ligj nuk përcaktohet- a është organizatë, a do të jetë institucion publik apo institucion nga organizatat e biznesit apo do të jetë i përzier, të cilat janë kompetencat e tjera? Në kohën sa unë e kam udhëhequr Ministrinë, shumë sinqertë nga Departamenti nuk ka mund me më bindë që kemi nevojë për një organizatë të tillë, arsyetimi i tyre i thjeshtë ka qenë se e ka Shqipëria, e ka Maqedonia dhe duhet me pasur edhe ne, por diçka konkrete nuk kanë mund të japin kështu që unë kam pas vendosur që nuk ka nevojë për një organizatë të tillë, çka është ajo tjetra, në vitin, në realitet në ligjin paraprak, ka ekzistuar Lidhja Turistike e Kosovës me ligj, por e cila kur nuk ka qenë e funksionalizuar dhe kurrë nuk ka punuar diçka tjetër.

Janë edhe disa çështje tjera të projektligjit, ka te çështja e licencimit të agjencioneve turistike. Po më duket që është, bëhet pak më vështirë apo në mënyrë diskrecionale çështja e shfrytëzimit të automjeteve të huaja nga agjencitë turistike. Deri tash ka qenë që ato marrin një licencë në Ministrinë e Infrastrukturës për transport dhe në bazë të asaj licence është normale që Ministria e Tregtisë dhe Industrisë i licencen ato agjencione. Tash është hequr ai obligim, kështu që mbetet, po më duket që mbetet një lluft apo një zbrazësi ligjore për ato agjencione, a duhet vetëm ta marrin licencën në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe të mos shkojnë absolutisht në Ministrinë e Infrastrukturës, apo duhet të dyja? Dhe në anën tjetër, nuk është hera e parë, kemi në ligj përsëritjen e disa neneve apo rregullimin, përfshirjen në ligj të disa çështjeve që rregullohen me ligjet tjera. Për shembull, orari i punës apo çështje tjera që kanë të bëjnë me lokalet, përcaktohen me Ligjin mbi Inspektoratin e Tregut dhe nuk ka nevojë që të jenë ligj.

Çështja e lëshimit të faturave apo dokumentacionit tjetër financiar, rregullohet me Ligjin mbi Administratën Tatimore dhe po ashtu nuk ka nevojë të ripërsëriten në këtë ligj. Ka edhe disa çështje tjera siç është ai me qeverisjen lokale dhe në zonat mbrojtëse. Në parim do të mundohemi në Komision të japim kontributin tonë që ta kemi ligjin sa më të mirë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, Zoti Kelmendi, e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Ju faleminderit!

I nderuar kryesues,

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Ne jemi dëshmitarë të gjithë se, sa i përket turizmit në Kosovë nuk është dhënë shumë hapësirë, gjegjësisht nuk i dhënë përparësi këtij sektori qysh pas përfundimit të luftës e deri me tani, e lufta, gjegjësisht paqja e arritur pas luftës, ka qenë një faktor i cili ka mundur të promovohet në opinion ndërkombëtar si një vend i cili ia vlen të vizitohet Kosova, ngase ne jemi dëshmitarë që shumë shtetas të huaj, qoftë të kontinentit evropian, qoftë jashtë Evropës, ende nuk e dinë se ku ndodhet Kosova e lere më të kenë njohuri se çfarë pasurie natyrore apo vende të cilat ia vlen të vizitohen, ka Kosova.

Kështu që, me këtë rast duhet dhënë shumë hapësirë promovimit të vendeve turistike të Kosovës, qoftë Bjeshkëve të Rugovës, atyre të Deçanit, Bjeshkëve të Sharrit dhe vendeve të ndryshme të cilat ia vlejné të vizitohen në Kosovë, ngase përmes turizmit pasurohet gjithashtu edhe vetë shteti i Kosovës dhe vetë qytetari i Kosovës. Ne jemi dëshmitar që shumë shtete në rajon, në Evropë mbijetojnë nga turizmi. Vetëm Kroacia para dy viteve kishte të ardhura nga turizmi mbi 8 miliardë euro. Kjo është një shumë mjaftë e madhe. Ne, është e vërtetë nuk kemi bregdet, por kemi Alpe dhe vende tjera të cilat na bëjnë më të pasur. Gjithashtu propozoj që në këtë Projektligj, në kuadër të Agjencionit Turistik të promovohet një agjencion i cili ka të bëjë me marketingun dhe promovimin e vlerave turistike të Kosovës ngase kjo është që i mungon Kosovës, të informohen shtetasit e huaj vërtetë se çka ka Kosova. Vite me radhë është folur për Alpet tona, qoftë ato të Rugovës apo të Sharrit, pjesë e një projekti ka qenë edhe ndërtimi i një teleferiku në qytetin e Pejës nga Karagaçi në Rugovë, i cili tash ka mbetur projekt i harruar, ku shembull është ai që është bërë në Dajt të Shqipërisë, e çka me një menaxhim dhe punë më të mirë, padyshim që do të arrijë të bëhet një qendër edhe më e mirë turistike se ajo e Dajtit. Kështu që propozoj që në këtë projektligj të parashihet edhe Agjencionin për Promovimin dhe Marketingun e Vendeve Turistike të Kosovës.

Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Zonja ministre, në qoftë se doni të informoni shtesë.

MINISTRJA MIMOZA KUSARI- LILA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ju falënderoj të gjithëve për komentet dhe përkrahje.

Unë kisha dashur vetëm disa sqarime të vogla në raport me ndryshim – plotësimin e këtij projektligji.

Së pari, sa i përket zonave të veçanta, neni 33/a i projektligjit e parasheh që komuna ka kompetenca të plota dhe ekskluzive në fushën e turizmit, përderisa ka të bëjë me interesin e zhvillimit lokal, duke respektuar standardet e përcaktuara me ligjet në fuqi dhe aktivitetet turistike në lokacionet e zonave të veçanta të mbrojtura duhet të jenë në

përputhje me ligjet në fuqi dhe trashëgiminë kulturore. Domethënë ato zona të veçanta të cilat janë të përcaktuara në ligj, shkojnë në përputhshmëri me këtë ligj.

Gjithashtu, sa i përket numrit të turistëve që vijnë në Kosovë, që nga qershori i vitit të kaluar, është bërë marrëveshja me Ministrin e Punëve të Brendshme dhe në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, gjendet numri i turistëve që vizitojnë Kosovën, në hyrje - dalje, qoftë përmes aeroporteve, qoftë përmes rrugëve si dhe sa i përket kategorizimit, dhe klasifikimit ajo që është e obliguar me këtë ligj, më duhet ta cek edhe një herë se shenja e klasifikimit duhet të vendoset dukshëm dhe e kategorizimit nëse ekziston nga organi kompetent, që mund të formohet pas formimit të Organizatës nacionale për turizmin. Unë jam shumë e vetëdijshme se turizmi në Kosovë nuk është në nivelin e duhur dhe konform kapaciteteve të cilat i ka Kosova, por gjithashtu duhet t'ju siguroj edhe një gjë se Qeveria e Republikës së Kosovës, e ka vënë në top prioritet të vetin zhvillimin e kompleksit, në veçanti asaj të Brezovicës dhe përmbylljen e këtij kompleksi brenda këtij viti, prandaj besoj që konform këtij zhvillimi dhe attributeve që i parasheh ky kompleks, do të jetë një derivim edhe për zhvillimin e vendeve tjera të natyrës së ngjashme në Kosovë.

Ju falënderoj edhe një herë dhe jemi të gatshëm për bashkëpunim të mëtutjeshëm.

**KRYESUESI:** Ju faleminderit!

Konstatoj se në mbledhje janë prezentë 89 deputetë. Po tani nuk është praktikë Liburn, nuk ta ka përmendur emrin, nuk ka replikë. Unë nuk e di, po nuk ke sqarimin e ka bërë ministria. Sikur ta kishte përmendur emrin, në rregull.

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratim në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për turizmin dhe shërbimet turistike.

Në mbledhje janë prezent thashë 89 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë, tani.

Ju faleminderit!

Konstatoj se me 89 vota “për”, 2 abstenime, asnjë “kundër”. Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për turizmin dhe shërbimet turistike.

Kërkohet nga Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Pika e gjashtë e rendit të ditës është

## **6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror**

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Infrastrukturës zotin Mujota, që para deputetëve të Kuvendit, ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

**MINISTRI FEHMI MUJOTA:** I nderuar, nënkryetar i Kuvendit!

E nderuara zëvendëskryeministre,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Kam kënaqësinë që të prezantoj sot para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Projektligjin për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror.

Projektligji parasheh themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit ajror si agjenci shtetërore, në pajtim me nenin 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Para dhënies me koncesion të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”, shërbimet e navigacionit ajror kanë qenë pjesë përbërëse e Aeroportit.

Qeveria e Republikës së Kosovës e ka mbajtur si përgjegjësi të shtetit ofrimin e shërbimeve të Navigacionit Ajror si një fushë strategjike i rëndësisë së veçantë. Për këtë arsye këto shërbime nuk janë dhënë në koncesion.

Ofrimi i këtyre shërbimeve prej koncensionimit të Aeroportit e këndej, bëhet nga ndërmarrja publike Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”, që është e ndarë nga operimet e kryerja nga partneri privat.

Mes miratimit të këtij projektligji ofruesi i shërbimeve të Navigacionit Ajror do të shndërrohet në agjenci të shtetit me status të qartë juridik dhe me mundësi të mëdha për zhvillim dhe rritjen e spektrit të shërbimeve të ofruara.

Miratimi i Ligjit për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror është identifikuar si sfidë dhe veprim prioritar në agjendën tonë të integriteteve evropiane.

Ky prioritet rrjedh edhe nga Raporti i Progresit 2011 për Republikën e Kosovës, i cili edhe për këtë vit ka çmuar arritje të vendit tonë në fushën e aviacionit civil.

Projektligji është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për aviacionin civil, Konventën e Aviacionit Civil Ndërkombëtar dhe kuadrin ligjor të Bashkimit Evropian në fushën e navigacionit ajror.

Si obligim që kemi sipas marrëveshjes për hapësirën e përbashkët evropiane të aviacionit, hartimi i këtij projektligji është bërë në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin Evropian dhe ekspertë ndërkombëtarë që na kanë përkrahur në këtë proces.

Projektligji gjithashtu reflekton edhe përgjegjësitë e NATO-së në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës.

Themelimi i Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror ka edhe ndikime financiare.

Sipas projektligjit, Agjencia do të financohet nga të hyrat e gjeneruar nga shërbimet e Navigacionit Ajror që u ofrojnë aeroplanëve që fluturojnë në hapësirën tonë ajrore. Është qëllimi ynë që kjo agjenci të jetë e vetë financuar 100% prej shërbimeve të ofruara. Tash për tash shërbimet ofrohen për aeroplanë që aterojnë dhe ngritën nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” dhe këto të hyra nuk mjaftojnë për vetë qëndrueshmëri financiare të Agjencisë. Prandaj, është me interes jetikë hapja e hapësirës së lartë ajrore të Kosovës në lartësinë mbi 9 kilometra për mbikalime komerciale. Hapja e hapësirës së lartë ajrore do të gjenerojë të hyra shtesë për të mbuluar shpenzimet operative të Agjencisë dhe për të investuar në ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve teknologjike dhe njerëzore.

Për këtë arsye, krahas hartimit të këtij projektligji, Qeveria e Republikës së Kosovës po punon ngushtë me partnerët e NATO-së dhe partnerët tjerë ndërkombëtarë në hapjen e hapësirës së lartë ajrore për mbikalime. Kjo hapësirë, siç është e ditur, është e mbyllur për mbikalime nga viti 1999 dhe është nën autoritetin e NATO-së. Prandaj, edhe vendimi për hapjen e hapësirës së lartë ajrore të Kosovës, do të merret në Këshillin e NATO-së duke i kaluar përgjegjësitë një shteti anëtar i cili do të marrë përsipër edhe ngritjen e kapaciteteve të plota për Agjencinë tonë të shërbimeve të Navigacionit Ajror.

Miratimi i këtij projektligji nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka rëndësi të veçantë në forcimin e sovranitetit të shtetit, rritjen e nivelit të shërbimeve në përputhje me standardet më të larta të sigurisë si dhe do të jetë një hap i rëndësishëm përpara në agjendën tonë të integriteteve evropiane.

Ne mirëpresim si Ministri kontributin e Komisionit parlamentar funksional, të gjithë deputetëve dhe grupeve të interesit, që ta kemi një ligj sa më funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional, zotin Pajaziti, që ta thotë fjalën në emër të Komisionit.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra, deputetë,

Komisioni funksional për Zhvillim, Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka shqyrtuar në mbledhjen e vet të fundit këtë projektligj. Duke pasur parasysh që infrastruktura ekzistuese në Kosovë ka qenë funksionale, është pritur kaherë që ky projektligj t'i dorëzohet Kuvendit. Ne e falënderojmë Ministrinë dhe rrjedhimisht

Qeverinë që ka sjell tanimë këtë projektligj i cili këtë mekanizëm e shndërron në një agjenci.

Prandaj, Komisioni duke u bazuar në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit i rekomandon Kuvendit, për miratim në parim këtë projektligj dhe i fton deputetët ta votojnë . Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, zonja Sala- Berisha e ka fjalën.

SALA BERISHA – SHALA: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje ministri i Infrastrukturës,

Të nderuar kolegë deputetë, ju të pranishëm,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar me vëmendje Projektligjin për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror.

Rëndësinë e këtij projektligji veç patëm rastin ta dëgjojmë edhe nga paraqitja e ministrit. Ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështesim në parim.

Ky projektligj themelon Agjencinë për Shërbimet e Navigacionit Ajror. Ky shërbim deri tani është kryer në kuadër të Aeroportit Ndërkombëtarë “Adem Jashari”, prej tani përmes këtij projektligji ky shërbim do të funksionojë i pavarur nga Aeroporti i Prishtinës.

Përmbajtja e projektligjit në përgjithësi i përmbush kërkesat për rregullimin e fushës, megjithatë në projektligj ka çështje të cilat duhet të sqarohen më tutje gjatë fazës së amendamentimit në Komisionin funksional.

Ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, kontributin tonë do ta japim gjatë fazës së amendamentimit dhe ftojë kolegët deputetët tjerë që t’i paraqesin amendamentet e tyre gjatë fazës nga miratimi në parim i këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i LDK-së, zoti Zharku.

LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar,

Kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e ka analizuar projektligjin dhe në parim e përkrah.

Kemi disa vërejtje parimore të themi sa i përket strukturës organizative dhe mos definimi i disa çështjeve të vetë Agjencionit.

E para, ka të bëjë me, Agjencioni a është pjesë e Ministrisë apo do të jetë pjesë e Qeverisë? Nismi prej asaj se emërimin e drejtorit e propozon ministri, por e emëron

Qeveria. Në parim jemi për atë që Agjencioni të jetë pjesë e Ministrisë dhe ministri të jetë ai që e emëron, thjesht që të përcaktohet përgjegjësia e saktë ku bie.

Tjetra, është e padefinuar mënyra e emërimit të drejtorit, thuhet që parashihet një konkurs i hapur, por nuk parashihet kurrfarë paneli intervistues apo një komision i cili do të bëjë përzgjedhjen apo thjesht të bëjë rekomandime për disa nga kandidatët.

Po ashtu nuk definohet a është shërbyes civil a janë pjesë të shërbyesve civilë drejtori dhe punëtorët e tjerë, dhe ka një mandat jo të rëndomtë.

E para është se ka një mandat 5 vjeçar,

E dyta, mandati i dytë jo i plotë, por vetëm mund të vazhdohet veç për 2 vite, kështu që është jo e pazakontë në krahasim me emërimet tjera kryeshefat apo drejtorët e agjencioneve ku dihet një mandat ose dy mandate, por një mandat e gjysmë nuk kemi pas raste tjera.

Çështje tjetër brengosëse besoj është zëvendësdrejtori, krijohet një përshtypje që zëvendësdrejtori i ka të gjitha kompetencat dhe në realitet nëse i merr i analizon disa ligje gjithë drejtorët e divizioneve i përgjigjen drejtorit përmes zëvendësdrejtorit, kështu që krijohet përshtypja që drejtorit i raporton vetëm zëvendësdrejtori.

Në anën tjetër, emërimi i zëvendësdrejtorit edhe i tij në Qeveri, besoj se krijon një dualizëm pushtete brenda në agjencion, kështu që nuk do të duhej të lejohej ajo çështje. Vetë rëndësia që u jepet një posti të tillë besoj se është e panevojshme.

Në fund, bartja e personalit prej Departamentit aktual në kuadër të Aeroportit në Agjencion, besoj se do të kemi disa probleme apo brenga. Bartja e tyre si numër 91 dhe posaçërisht niveli i tyre i pagave.

Në fund, do të duhej të caktohet në mënyrë më të qartë pavarësia buxhetore e agjencionit. Thuhet që Agjencioni shfrytëzon të hyrat e saj, për diferencën negative apo për dibalancin që ekziston për t' i mbuluar shpenzimet i drejtohet Qeverisë, i drejtohet buxhetit të Kosovës. Unë besoj se ajo duhet të ketë tretmanin e njëjtë sikurse agjencionet tjera, të bëjë propozimet dhe normalisht që të hyrat e tyre nuk do të thotë konsiderohen apriori të hyrat e Agjencionit, por të hyra të buxhetit, kurse buxheti i tyre të shqyrtohet sikurse i agjencioneve tjera. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit!

Nga Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, zotit Ymeri e ka fjalën.

**VISAR YMERI:** Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar këtë ligj dhe do ta përkrahë në parim, megjithatë i kemi disa vërejtje në të, të cilat janë nganjëherë edhe të natyrës teknike.

Së pari, një pjesë e konsiderueshme e ligjit merret me detyrat, përgjegjësitë e drejtorit, zëvendës drejtorit e kështu me radhë, me emërimin e tyre, mënyra se si përzgjidhen, madje, madje në projektligj faktikisht edhe është përpiluar konkursi për drejtorin, që mendoj që ka qenë e tepërt që një ligj të përmbajë pikat e konkursit ashtu të paktën i kam lexuar unë, dhe në atë janë disa paqartësi. Për shembull, te pika e fundit aty ku flitet për drejtorin thuhet që duhet të ketë integritet të lartë moral edhe profesional. Unë nuk e di si do ta matim ne me ligj integritetin moral të drejtorit ose të kandidatit për drejtor.

Po ashtu në disa raste ka, kisha me thënë përdorim të gjuhës i cili është i pakuptimtë në gjuhën shqipe. Nuk di nëse këtu është problemi prej përkthimit nga anglishtja i cili në gjuhën shqipe pastaj ka dalë disi i përçudnuar, për shembull e kisha marrë në këtë rast nenin 24, ku flitet për punësimin edhe çështje sociale të punësuarve, pra ku flitet për të drejtën që punëtorët të kenë greva. Së pari, natyrisht, ky nen më duket tërësisht i panevojshëm për shkak se këtu thuhet që çfarëdo veprimi i personelit të ASHNA-s siç janë grevat dhe praktikatat asimiluese që mund të rrezikojnë jetën, sigurinë personale apo shëndetin e personave është i ndaluar, kjo ndalesë bëhet edhe me ligje tjera. Nuk mendoj që këtu duhet ta kemi këtë ndalesë për grevën. natyrisht që edhe këta punëtorë duhet ta gëzojnë të drejtën e grevës.

Mirëpo, këtu e kam edhe vërejtjen te përkthimi në anglisht thuhet: “such as strikes and assimilated practices”- ndërkohë që në gjuhën shqipe është përkthyer siç janë “grevat dhe praktikatat asimiluese” “such as strikes and assimilated practices”- nuk është praktikë asimiluese, por është praktikë e ngjashme me grevën. Askush nuk do të ndërmarrë aty masa për t’ia asimiluar punonjësit, konsideroj unë, ndoshta edhe do të ketë një çështje të tillë.

Po ashtu një vërejtje tjetër, është edhe për sa i përket marrëdhënies që do ta ketë ASHNA me ofruesit ose operatorët tjerë të aeroporteve. Këtu natyrisht është fjala për operatorin Limak të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, ku thuhet që ASHNA do të ketë ose do të jetë përgjegjëse për prokurimin, mirëmbajtjen, instalimin e kështu me radhë të pajisjeve teknologjike për ta kryer punën e vetë. Ndërkohë që, po ashtu kërkohet që të nënshkruhet një memorandum mirëkuptimi me operatorin ose me operatorin e Aeroportit Ndërkombëtar, i cili memorandum do ta përcaktojë pronësinë për këto çështje. Unë mendoj që pronësia është e përcaktuar dhe duhet të jetë e përcaktuar me vetë faktin që ASHNA i blen dhe i mirëmban pajisjet, pra ASHNA është pronar i këtyre pajisjeve dhe nuk mendoj që kjo duhet të vihet në diskutim, as me memorandum mirëkuptimi dhe me asnjë operatorë tjetër. Pra, të mos shfrytëzohet ASHNA agjenci shtetërore përmes së cilës do të bëhet bartja e të mirave publike te një operator privatë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Ymeri!  
Fjalën e ka zoti Isufi në emër të AAK-së.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryesues!  
Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Grupi Parlamentar e përkrah në parim Projektligjin për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror, duke theksuar se ky

projektligj ka nevojë për një saktësim më të mirë të elementeve të cilat kanë të bëjë edhe me përbërjen, por edhe me detyrat që janë brenda këtij agjencioni.

Prandaj, meqë kemi të bëjmë me punën që do të bëhet në Komision, do ta japim kontributin tonë me amendamentimet që do të jenë në të ardhmen.

KRYESUESI: Faleminderit!

Koalicioni Kosova e Re, deputetja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Koalicioni për Kosovën e Re e ka shqyrtuar projektligjin i cili them shumë të drejtën fatbardhësisht që nuk është miratuar edhe në prezantimin e ministrit u tha që s'është miratuar ky ligj para koncesionimit të Aeroportit. Duke e marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji, mund të themi se të gjitha rekomandimet të cilat u dhanë prej grupeve parlamentare të cilat janë në Kuvend, janë të mirëseardhura për amendamentim të projektligjit, mirëpo projektligji si projektligj është i një rëndësie të veçantë për arsye se prek definitivisht edhe çështjen të cilën ne e kemi akoma të padefinuar, çështjen e hapësirës ajrore që është në kompetencë të NATO-së. Dhe shpresoj dhe besoj shumë që projektligji është në përputhshmëri të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me legjislacionet në fuqi, por njëkohësisht është ligj i cili na japë ndoshta kompetencat pak më të mëdha si shtet i ri në fushën e navigacionit.

Ministrin, mund ta përshëndesim për punën që e ka bërë në këtë projektligj, se është projektligj edhe një herë po them i rëndësisë së veçantë të shtetit të Kosovës për formimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigimit Ajror për arsye se Kosova duhet të plotësojë edhe këtë konditën që në të ardhmen të jemi shtet me të gjitha organizmat të cilat i duhen një shteti.

Koalicioni për Kosovën e Re, e përkrah projektligjin dhe gjatë amendamentimit shpresoj që disa sugjerime të cilat u dhanë këtu do të merren parasysh në Komisionin parlamentar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

SLS, deputetja Kostiq.

BISERKA KOSTIČ: Zahvaljujem, gospodine podpredsedniče!

Parlamentarna grupa Samostane liberalne stranke takođe razmatrala Nacrt zakona o osnivanju Agencije za službu vazdušne navigacije. Podržaćemo Nacrt zakona u načelu a svoje primedbe i preporuke daćemo u Komisiji. Hvala!

KRYESUESI: faleminderit!

Grupi Parlamentar "6+", Zonja Balje.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Ovaj Nacrt zakona ima za cilj osnivanje Agencije za vazdušne navigacijske usluge u Republici Kosova, sa ciljem obezbeđivanje infrastrukture i vazdušne navigacijske usluga kao nezavisno organizaciju.

Ovaj Nacrt zakona treba da reguliše prava i obaveze ove agencije, analizirali smo ga i smatramo ga vrlo značajnim za razvoj tržište civilne avijacije, i glasaćemo za njega. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit!

Radha është e deputetëve, zoti Kuleta, e ka fjalën.

AGIM KULETA: Faleminderit, zoti kryesues!

Deputetë të nderuar,

Lëvizja për Bashkim e mirëpret procedimin e këtij projektligji në Kuvend duke pasur parasysh rëndësinë e madhe që ka miratimi i tij për zhvillimin e sektorit të aviacionit civil dhe marrjen e plotë të përgjegjësisë në fushën e shërbimeve të navigacionit ajror.

Madje, konsiderojmë që ky projektligj është vonuar, duke pasur parasysh që ligji që rregullon këtë çështje është dashur të jetë në fuqi që nga 4 prilli i vitit të kaluar kur është dhënë aeroporti në koncesion, sepse pjesa e mbetur e pa koncesionuar e Aeroportit, pra Shërbimi i kontrollit të trafikut ajror ka vazhduar të funksionojë si ndërmarrje publike gjysmake pa status të qartë juridik.

Me këtë ligj kjo ndërmarrje publike parashikohet të shndërrohet në Agjenci Shtetërore që i raporton Kuvendit dhe kjo është një zgjidhje e mirë, sepse ofrimi i këtyre shërbimeve që lidhen me sovranitetin e shtetit duhet të bëhet nga një Agjenci Shtetërore e jo nga ndërmarrjet publike. Kjo është një praktikë që kanë ndjekur edhe shumë shtete të tjera.

Ne kemi bërë një studim krahasues midis këtij projektligji dhe Ligjit për aviacionin civil dhe nuk kemi vërejtur ndonjë shpërputhje apo kundërthënie, mirëpo ajo që kemi vërejtur është se në shumë nene të këtij projektligji ka përsëritje të panevojshme të dispozitave të ligjit të përmendur, pra atij për aviacionin civil.

Sa i përket aspektit financiar e meta më e madhe është që kjo agjenci nuk arrin të vetëfinancohet në mënyrë të plotë. Ne konsiderojmë se është shumë me rëndësi që agjencia vetë të financohet plotësisht, sepse duke pasur parasysh koston e madhe të personelit të saj dhe afrimit të shërbimeve do të jetë barrë e rëndë për buxhetin e shtetit.

Një element tjetër i rëndësishëm është fakti që projektligji parasheh që kuadri ligjor i BE-së në fushën e Navigacionit Ajror të bëhet pjesë e rendit të brendshëm ligjor të Republikës së Kosovës. Kjo është bazë e mirë për të garantuar shërbime me cilësi dhe standarde të larta.

Në fund më duhet të japë një vërejtje që tanimë më është bërë kronike për projektligjet që vijnë në Kuvend dhe që ka të bëjë me nevojën serioze për lekturë gjuhësore. Gjithashtu në disa nene në versionin shqip formulimet tingëllojnë si një përkthim i vrazhdë nga

gjuha angleze. Sidoqoftë Lëvizja për Bashkim e mirëpret këtë projektligj dhe përkrah miratimin e tij në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Morina e ka fjalën!

SALI MORINA: Faleminderit, kryesues!

I nderuari ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe nga parafolësit u tha, çështja e këtij ligji është njëri prej ligjeve që kërkon prioritet dhe njëkohësisht është në Raportin e Progresit, por vërejtjet e mia pikërisht kanë të bëjnë me çështjen e deklaratave financiare të cilat jepen nga Ministria e MEF-it edhe pse ministri i Ekonomisë nuk qenka këtu.

Një dukuri e cila ka ndodhur gjatë viteve që lamë pas, shumë projektligje kanë ardhur në këtë parlament, me të cilët nga deklaratat financiare është kërkuar që në mungesë ose në rritjen e implikimeve buxhetor këto ligje mund të jenë të paimplementueshme. Edhe vetë fakti në kuadër të këtij ligji me krijimin e këtij agjencioni me të cilën ende është i paqartë se këtë agjencion a do ta krijojë Qeveria e Republikës së Kosovës apo do ta krijojë Ministria përkatëse, në këtë rast parasheh që në kuadër të kornizës afatmesme 2011 – 2013 ky projektligj nuk është i përfshirë.

Prandaj, ne po biem në kundërshtim me vetë Rregulloren e Parlamentit të Kosovës, sepse e para deklarata financiare është një diçka që jep një siguri në implementimin e ligjit. Dhe ne kemi shumë ligje të tilla edhe gjatë vitit që lamë pas, të cilat janë aprovuar në këtë parlament por po mbesin të paimplementueshme.

Prandaj, do të ishte mirë që edhe herrave tjera, do të thotë edhe pse ky ligj parasheh implikime të mëdha buxhetore dhe njëkohësisht parasheh një rritje të një stafi bukur të madh ose bartje e një stafit prej një departamenti tash në krijimin e këtij agjencioni, agjencionet e krijuara, do të thotë, si nga ana e Qeverisë, po ashtu edhe nga ana e disa institucioneve, kur ta marrësh në total pagat e sidomos kryeshefit të agjencioneve janë paga jashtëzakonisht të mëdha dhe po del se një kryeshef e ka një pagë më të madhe se pakën e një ministri apo zëvendësministri. Dhe mendoj që kjo dukuri duhet të parandalohet dhe duhet të sistematizohet nga ana e vetë Qeverisë se nuk mund ta ketë pagën një kryeshef i një agjencioni më të madhe se sa pagën e një ministri.

Ne në parim do ta mbështesim, por do të ishte mirë që deklaratat të cilat i jep MEF-i të kihen parasysh nga ana e Qeverisë dhe Kryesia e Parlamentit duhet t'i ketë parasysh gjatë këtij viti ato ligje të cilat nuk kanë deklarata financiare mos t'i sjellë në Parlament. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti Hashim Deshishku e ka fjalën.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, zoti kryesues Haliti!

Të nderuara ministra,

Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete,  
Për shqyrtim kemi njërën prej ligjeve më të rëndësishëm që rregullojnë standardet për organizimin e mekanizmave për përcjelljen e kontrollimit të qarkullimit ajror përbrenda hapësirës ajrore të Kosovës.

Po ashtu kur merren parasysh përgjegjësitë e agjencisë të cilat dalin nga ky ligj ajo ka rëndësi të veçantë edhe kur është në pyetje siguria e trafikut ajror dhe në përgjegjësi siguria e jetës së udhëtarëve.

Numri më i madh i neneve në këtë ligj merren me mënyrën e organizimit të agjencisë, emërimin e drejtorit dhe zëvendësin e tij si dhe të stafit tjetër. Nuk kam ndonjë vërejtje esenciale por që këtu do ta paraqes disa dilema apo paqartësi që dalin nga ky projektligj, por në parim këtë projektligj do ta përkrahim.

Në nenin 5.2, thuhet se ASHN-ja është një Agjenci e pavarur e themeluar në pajtim me nenin 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për të siguruar infrastrukturën dhe shërbimet e navigimit ajror në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës.

Ndërkaq, në nenin 142 të Kushtetutës thotë: Citoj: “Agjencitë e pavarura të Republikës së Kosovës janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre. Agjencitë e pavarura funksionet e tyre i kryejnë në mënyrë të pavarur në çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës”. Së pari propozoj që pika 2 e nenit të këtij projektligji të riformulohet, përmbajtja e tij duhet të jetë: “ASHN-ja është agjenci e pavarur e themeluar në pajtim me nenin 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”. Pjesa tjetër e kësaj pike mund të thuhet në një pikë të veçantë me qenë se ky nen i Kushtetutës nuk ka të bëjë taksitativisht me navigacionin, por me agjencitë e pavarura.

Nën dy, ky nen i Kushtetutës thotë se agjencitë e pavarura themelohen nga Kuvendi i Kosovës, ndërsa pos nxjerrjes së këtij ligji legjislativi i vendit nuk ka asnjë kompetencë mbi këtë agjenci. Ajo kryesisht mbetet përgjegjësi e Qeverisë, përkatësisht e Ministrisë përkatëse, qoftë kur është në pyetje rekrutimi i stafit, lejimi i buxhetit apo raportimi për punën që bën. Për shkak të statusit ASHN-ja si agjenci e pavarur propozoj që emërimi i drejtorit të bëhet nga Kuvendi i Kosovës, duke u bazuar në listën e kandidatëve që e nxjerr Qeveria, pas një procedure të rregullt konkurruese që e udhëheq Ministria e Infrastrukturës.

Nën 3, duke pasur parasysh këtë propozim, atëherë ndryshon neni 6, ku bëhet fjalë për emërimin dhe shkarkimin e drejtorit. Propozoj formulimin e ri: “Drejtorin e emëron Kuvendi i Republikës së Kosovës, pas dorëzimit të listës prej së paku 3 kandidatëve, të cilët i kanë marrë përmes rekomandimit nga ministri, ministri para rekomandimi përmes një konkursi të hapur dhe transparent e tjera. Pjesa tjetër e këtij neni mbetet njësoj si është në këtë projektligj.

Kam edhe një vërejtje që më shumë është e natyrës teknike. Në nenin 10.1.4 bëhet fjalë për angazhimin e stafit teknik profesional. Në këtë nen thuhet se shpallja bëhet citoj:

“edhe në një gazetë në gjuhën angleze në tirazh të madh në Bashkimin Evropian”, propozoj që këtu të thuhet “se shpallja bëhet së paku në tri medime vendore apo në mjete të tjera të informimit ku ka qasje edhe opinioni i brendshëm” Me këtë krijohet mundësia e komunikimit me opinionin e brendshëm si dhe përzgjedhjes së kandidatëve nga vendi nëse ata i plotësojnë pushtetet e kërkuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Diskutimet e deputetëve janë ezauruar.

Tani fjalën e ka ministri Fehmi Mujota, në qoftë se dëshiron të bëjë sqarime shtesë.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Unë dua të falënderoj gjithë deputetët për një kontribut që dhanë në diskutim për këtë projektligj. E çmoj shumë çdo vërejtje parimore që është dhënë në këtë rast. Dhe vetëm sa për të qartësuar edhe një herë që Projektligji nuk është në kundërshtim me Kushtetutën, saktësisht edhe në leximin tim paraprakë e thashë se projektligji parasheh themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror si agjenci shtetërore në pajtim me nenin 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, prandaj këto dilema duhet të hiqen.

Ndërsa për të gjitha vërejtjet tuaja me besnikëri do t’i përcjell tek njerëzit që janë kompetent brenda Ministrisë për të qenë pjesë e punës në Komisionin parlamentar dhe sigurisht se do të merren parasysh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratim në parim të Projektligjit për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror.

Në mbledhje janë prezentë 82 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani. Faleminderit!

Konstatohet se me 79 vota “për”, 1 abstenim dhe asnjë “kundër”, Kuvendi miratohet në parim Projektligjin për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror.

Kërkohet nga Komisioni funksional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës që është:

## **7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndihmë juridike falas**

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për ndihmë juridike falas dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Fjalën e ka zoti Behar Selimi, në emër të Komisionit.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Legjislacion, në cilësi të Komisionit funksional, në mbledhjen e mbajtur fillimisht më 16 nëntor 2011 dhe pastaj më 23 janar 2012 e rishqyrtoi Projektligjin për ndihmë juridike falas numër 04/L-17 dhe amendamentet e propozuara nga ky Komision dhe nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe vlerësuan se projektligji me amendamente të propozuara nga këto komisione kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Komisioni konstaton se projektligji dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional dhe nga Komisioni për Buxhet dhe Financa e përbëjnë një kornizë ligjore shumë praktike dhe efektive me rëndësi të veçantë që do të mundësonte qytetarëve ofrimin e ndihmës juridike falas për t'u përfaqësuar para organeve shtetërore për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të garantuara me Kushtetutë. Së këndejmi, Komisioni për Legjislacion duke u bazuar në konstatimet e theksuara vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë raport, të shqyrtohet dhe të miratohet Projektligji për ndihmë juridike falas numër 04/L-17 me amendamentet e propozuara nga komisionet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Haxhiu, e keni kërkuar fjalën. Urdhëroni!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Unë e kam thënë, mirëpo po e përsëris prapë se ligji si ligj është i mirë, mirëpo ne si grup parlamentar nuk do ta votojmë një projektligj i cili do të mbetet vetëm në letër, i cili do të jetë i pazbatueshëm dhe nuk do t'i plotësoj nevojat e qytetarëve. Pra, praktika të tilla kemi pasur edhe në të kaluarën dhe unë mendoj që duhet të ndalen praktikat e tilla. Kur ka qenë i ftuar në grupin punues përfaqësuesi i ndihmës juridike falas, ka pasur ankesa se ka mungesë buxheti, ndërsa tani u janë shkurtuar mjetet edhe më shumë nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Ky rekomandim nga Komisioni për Legjislacion është i tillë pasi që është mbivotuar nga deputetët e partisë në pushtet dhe jo pse Komisioni për Legjislacion e ka vlerësuar si të tillë. Pra, për shkak se është kështu si është ne nuk do të votojmë në favor të këtij projektligji.

KRYESUESI: Faleminderit!

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 13 amendamente.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka propozuar 5 amendamente, amendamentet numër 5, 8, 9, 12 dhe 13, me përkrahjen e Komisionit funksional.

Po vazhdojmë me miratimin e amendamenteve, siç e kemi praktikë, me qenë se s'ka kundërshtime me votim të deklaruar.

Amendamenti 1.

A ka "kundër"?

Nuk ka.

A ka abstenim?

Një abstenim  
Miratohet.  
Prezentë janë 80 deputetë.

Amendamenti 2.  
“Kundër”, nuk ka.  
Abstenim, nuk ka.  
Miratohet.

Amendamenti 3.  
“Kundër”, nuk ka.  
1 abstenim.  
Miratohet..

Amendamenti 4.  
“Kundër, nuk ka.  
Abstenim, nuk ka.  
Miratohet.

Amendamenti 5.  
“Kundër”, nuk ka.  
Abstenim, nuk ka.  
Miratohet.

Amendamenti 6.  
“Kundër”, nuk ka.  
Abstenim, nuk ka,  
Miratohet.

Amendamenti 7.  
“Kundër”, nuk ka.  
Abstenim, nuk ka.  
Miratohet.

Amendamenti 8.  
“Kundër”, nuk ka,  
Abstenim, nuk ka.  
Miratohet.

Amendamenti 9.  
“Kundër”, nuk ka,  
Abstenim, nuk ka.  
Miratohet.

Amendamenti 10.

“Kundër”, nuk ka.  
Abstenim, nuk ka.  
Miratohet .

Amendamenti 11.  
“Kundër”, nuk ka.  
Abstenim, nuk ka.  
Miratohet.

Amendamenti 12.  
“Kundër”, nuk ka.  
Abstenim, nuk ka.  
Miratohet.

Amendamenti 13 i fundit,  
“Kundër”, nuk ka,  
Abstenim, nuk ka.  
Miratohet.

Votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.  
Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani: Faleminderit!  
Konstatoj se me 61 vota “për”, 15 abstenime dhe asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për ndihmë juridike falas.

Me kaq përfundojmë seancën e sotme.

Mirupafshim, në seancën e ardhshme!

*E përgatiti:*  
*Njësia për transkriptim dhe lekturë*